

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPTI
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 29 QERSHOR 2006

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 29. JUNA 2006.GOD.

QERSHOR – JUNI 2006

RENDI I DITËS

Pjesa e parë:

1. Fjala e Përfaqësuesit. Special të Sekretarit të Përgjithshëm, z. Soren Jessen Petersen drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me rastin e përfundimit të misionit të tij në Kosovë.

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të mbajtur me 15 qershor 2006,
3. Pyetjet e deputetëve për Qeverinë,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peshkatarinë dhe akuakulturë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Kosovë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik,
7. Shqyrtimi i Raportit lidhur me vërejtjet e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut në Ligjin për të drejtat e autorit dhe për të drejtat e përfaqësuesit nr. 2004/45 miratuar më 27.9.2004,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullator të prokurimit publik për vitin 2005,
9. Interpelanca e ministrit Ardian Gjini, më kërkesë të deputetit Naser Osmani dhe të dhjetë deputetëve nga radhët e G/P të LDK-së.

DNEVNI RED

Prvi deo:

1. Reč Specijalnog predstavnika generalnog sekretara g-dina Sorena Jessena Petersena u obraćanju poslanicima Skupštine Kosova, povodom zavrsetka njegove misije na Kosovu.

Radni deo

1. Usvajanje dnevnog reda,
2. Usvajanje zapisnika sa plenarne sednice od 15. juna 2006.god.
3. Pitanja poslanika za Vladu,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o ribarstvu i akvakulturi,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o javnoj nabavci na Kosovu,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izdavanju školskih udžbenika nastavnih sredstava, školske lektire i pedagoške dokumentacije,
7. Razmatranje izveštaja sa primedbama Pravne kancelarije UNMIK-a na Nacrt zakona o autorskim i srodnim pravima br.2004/45, usvojen 27.09.2004.god.
8. Prvo razmatranje izveštaja Regulativne komisije za javnu nabavku za 2005.god.
9. Interpelacija ministra Ardiana Đinija na zahtev poslanika Namera Osmanija i deset poslanika iz redova PG DSK.

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës

Udhëhequr nga kryetari i Kuvendit Kolë Berisha,
Bashkëkryesues Gazmend Muhaxheri

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – I nderuari president Sejdiu, të nderuar kolegë deputetë, i nderuar Kabinetit qeveritar. Siç e dini sipas rendit të ditës kjo pjesë e seancës së sotme plenare ka karakter solemn, sepse para jush me një fjalë rasti do të paraqitet njeriu i parë i UNMIK-ut ,të cilit këto ditë i përfundon misioni i shefit të OKB-së në Kosovë. Për respektin që kam ndaj tij, më lejoni që fjalën time të rastit ta praqes në foltoren e Parlamentit.

I nderuari president Sejdiu.

I nderuari z. Petersen, z. Shuk, përfaqësues të zyrave të akredituara në Kosovë që unë dëshiroj t'i quaj ambasadorë, të nderuar të pranishëm, koha ecën shumë shpejt kur udhëton me njerëz të mirë. Z. Petersen ne bëmë së bashku një copë rrugë dhe shumë shpejt erdhi kjo ndarje, do të donim të zgjaste ende qëndrimi juaj këtu ,për t'i finalizuar bashkërisht proceset për të cilat punuam këto vite. Sidoqoftë i kuptojmë arsyet e largimit tuaj. Do t'ju l kujtojmë për një kohë të gjatë dhe shpesh, në çdo situatë, sepse na latë një model brilant të veprimit, të reagimit, të politikanit të matur e të vendosur njëkohësisht, na latë një model të veprimtarit që në momentin e duhur është në vendin e duhur, qoftë për t'i zhbllokuar proceset apo për t'u dhënë shpirt projekteve të ndryshme.

Z. Soren Jesen Petersen Kosova në historinë e saj shpeshherë i ka ndierë në kurriz dhe i ka vuajtur pasojat e paraqitjes së shtrembëru të thënave para botës, prandaj kemi konsideratë për miqtë dhe nuk do t'i harrojmë kurrë të gjithë ata që e thanë të vërtetën për ne. Pikërisht këtë e keni bërë edhe ju, z. Petersen ,prandaj Kosova është shumë mirënjohëse, ju na dhatë modelin e njeriut që ka guximin ta thotë të vërtetën dhe ta mbrojë atë, jeni modeli i veprimit harmonik të njeriut dhe të politikanit. Kemi kaluar këta 2 vjet çaste të vështira, por në përpjekjet e tejkalimit të tyre na është forcuar dëshira për bashkëpunim. Besimi lehtëson bashkëpunimin, nëpërmjet jush sot na ka kuptuar më lehtë, ashtu siç jemi, përveç kësaj ju do të bëni ende për Kosovën kudo që të jeni, për këtë jemi të sigurtë. Z. Petersen, duhet ta dini se ne ju kemi besuar kur na thatë këto ditë se do ta keni me vete Kosovën dhe ndjenjën miqësore për të.

Me angazhimin tuaj të palodhshëm keni vënë një gur të madh dhe të fortë në themelin e institucioneve të Kosovës .me të cilin shpresoj se do të krenohemi edhe ne edhe ju, siç do të krenohemi të gjithë së bashku për çdo gjë që e kemi bërë bashkërisht gjatë këtyre viteve në Kosovë.

Më vjen mirë që kam rastin t'i them këto gjëra përzemërsisht dhe sinqerisht që nuk janë vetëm fjalë kurtuazie sa për t'u thënë në momente ndarjesh, por edhe më mirë më vjen që ju e dini, të gjithë e dini se këto fjalë i mendojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Tani ky takim është i fundit ,në të cilin e këmbëjmë ndonjë mendim në cilësinë e shefit të UNMIK-ut, por pas kësaj nuk do të jeni në këtë cilësi, por do të vazhdoni të jeni mik i Kosovës dhe kjo është shumë dhe në traditën tonë kjo është e shenjtë. Sot unë dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, institucionet dhe qytetarët e Kosovës kemi vetëm një

përshëndetje *Mirë u pafshim z. Petersen, sa më . parë.* Kurdoherë që ju jepet rasti do të na gëzoni me vizitën tuaj. Ju tashmë jeni pjesë e Kosovës z. Petersen, tani foltorja është juaja. *Urdhëroni
Duartrokitje në sallë.*

SHEFI I UNMIK-ut SOREN JESEN PETERSEN – Z. kryetar Sejdiu, kryetar i Kuvendit z. Berisha, kryeministër, anëtarë të Kuvendit, anëtarë të Qeverisë, të nderuar mysafirë.

Më lejoni të filloj duke falënderuar kryetarin, Kryesinë dhe Kuvendin që më kanë ftuar t'ju flas sot dhe do fillojë duke shprehur respektin tim për kryetarin e Kuvendit që e ka bërë këtë vend këtu shtëpi të vërtetë të demokracisë dhe zë të vërtetë të demokracisë. Është e qartë se unë qëndroj këtu para jush sot me shumë emocione, qartë ka qenë një vendim shumë i vështirë për t'u larguar nga ky vend i mrekullueshëm dhe nga kjo punë me shumë sfida, por ,po ashtu, ka qenë shumë vështirë të rri larg familjes sime për 2 vjet e gjysmë, mirëpo në të njëjtën kohë e kam pasur më lehtë të largohem ,sepse edhe trupi im do të fluturoj nga këtu nesër në mëngjes, unë do të lë një pjesë të madhe të zemrës sime këtu në Kosovë me ju dhe me njerëzit e Kosovës. Unë po largohem pas 2 vjetësh që kanë qenë vite që më kanë shpërblyer dhe më kanë lodhur, kanë qenë vite sfide kur është kërkuar punë e madhe nga unë. Unë në të vërtetë besoj se gjatë këtyre dy vjetëve së bashku kemi bërë rrugë të gjatë. Fakti se procesi i statusit është duke u futur në fazën kryesore është një konfirmim dhe demonstrim i qartë i progresit që kemi arritur të gjithë së bashku dhe ky progres është meritë e të gjithë juve, është konfirmuar edhe në raste të shumta nga Këshilli i Sigurimit në seanca të vazhdueshme në të cilat kam marrë pjesë nga nëntori i vitit 2004. Sot me ju dua t'i ndaj disa nga mendimet personale, krenohem se duke punuar me të gjithë ju kemi arritur shumë, por në të njëjtën kohë e dimë se gjatë dy vjetëve të fundit së bashku kemi kaluar disa momente shumë të vështira, disa kriza të mundshme, por gjithmonë kam besuar fuqishëm se duke u përballur me kundërthëniet dhe me kundërshti forcoheni si njerëz, por edhe si shoqëri. Unë mendoj se Kosova është një shembull shumë i mirë ,të gjithë e dimë se Kosova ka pasur kundërshtime shumë vite,të gjithë e dimë se edhe gjatë dy vjetëve të kaluara shoqëria u ballafaqua me momente shumë të vështira. Pra Kosova është një shembull i qartë i tezës sime se nga kundërshtimet lind fuqia e demokracisë dhe e karaktereve individuale. Më lejoni të përmendi disa nga momentet më të vështira, jo për të folur për vështirësitë, por për të demonstruar se si ato çdoherë kanë çuar drejt një Kosove më të fortë. Së pari dua të flas për zgjedhjet e vitit 2004. Më lejoni t'i përkujtoj se ato është thënë se janë të drejta, por po ashtu na vie keq për vendimin që sipas mendimit tim, të gabuar të Beogradit, që t'i dekurajojë serbët e Kosovës nga pjesëmarrja në zgjedhje, që ishin moment krenarie për Kosovën, por zgjedhjet po ashtu çuan drejt një përvoje të re për Kosovën. Për herë të parë në histori të kohëve të fundit Kosova doli nga zgjedhjet me një qeveri koalicioni dhe me një opozitë. Mendoj se ishte vështirë për të dyja palët. Qeveria siguriht ballafaqohej me një gjendje ku ishte e shikuar deri në hollësi nga opozita dhe ashtu duhet të jetë, mendoj se kjo i ka ndihmuar Qeverisë që të kryejë punët edhe më mirë ,duke i dëgjuar zërat kritikë të kësaj opozite dhe duke bërë përpjekje që t'i zgjidhë shqetësimet legjitime të shprehura, por ishte vështirë edhe për opozitën, kjo ishte hera e parë që Kosova kishte opozitë dhe për të gjetur profilin apo vendin e duhur në një ambient

demokratik ,është e vështirë sipas përvojës sime. Unë besoj se opozita tani e ka gjetur profilin dhe rolin e saj, por po ashtu ka kontribuar në masë të madhe për të krijuar demokracinë. Pak muaj pas formimit të koalicionit u ballafaquam me një moment të vështirë kur ish- kryeministri Ramush Haradinaj vendosi të jepte dorëheqje dhe menjëherë u nis për në Hagë, por edhe në atë moment Kosova ia dërgoi disa porosi shumë të rëndësishme Evropës dhe botës, reagimi dinjitoz dhe i matur i udhëheqësve dhe i të gjithë juve ,i Ramush Haradinajt dhe i popullit të Kosovës, dha një pamje tjetër për Kosovën në Evropë dhe në botë . Ndonëse kishte shumë dyshime, ka ende për drejtësinë e këtij veprimi gjyqësor ,shoqëria dhe Ramush Haradinaj vetë demonstuan përkushtim për të pranuar bashkëpunimin me drejtësinë dhe me Tribunalin e Hagës dhe ky ishte një shembull i mirë, një shembull që iu dërgua jo vetëm vendeve të tjera në këtë rajon të Evropës, ishin momente të vështira, por momente që të gjithë ju dhe të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të jeni krenarë. Reagimi juaj dinjitoz dhe i matur ishte një nga ngjarjet më të rëndësishme kjo,mendoj se e ka shtyrë Kosovën kaq afër në përcaktimin e statusit të saj.

Së treti, mendoj se është fakt që pasi për herë të parë kishim koalicion kemi pasur disa kufizime në vitin 2004, ka pasur rrezik në disa momente se mund të futemi në periudhë të jo stabilitetit dhe të ndarjes. Për këtë arsye pas konsultimeve të ngushta me udhëheqësit politikë vendosa ta krijoja një forum, e di se ka qenë vendim kontraverz në atë kohë, me të drejtë shqetësoheshim se ishim duke zëvendësuar proceset demokratike me diçka që nuk ishte demokratike, por po ashtu besoj se të gjithë e kuptonin rëndësinë që të ruhej uniteti, rreth- qëllimeve strategjike me të cilat Kosova do të ballafaqohej do të thotë përgatitja dhe shkuarja drejt bisedave për status. Për mua kurrë nuk ka pasur dyshime se ky forum ishte një prekursor. për krijimin e duhur dhe krijimi i duhur ishte ajo që kemi sot një ekip negociator që udhëhiqet nga kryetari i Kosovës dhe që ka në përbërje udhëheqësit kryesorë të Kosovës. Besoj se jam shumë i kënaqur që ekipi negociator është zhvilluar në bazë të përvojës sonë në këtë forum. Një test tjetër i vështirë për Kosovën ishte rishikimi gjithëpërfshirës i implementimit të standardeve. Zgjati katër pesë muaj, që absorbuan po thuaj se tërë energjinë e udhëheqësve politikë të popullit të Kosovës.

Por ky rishikim që eventualisht çoj drejtë një konfirmimi të progresit që kishte arritur Kosova, absorboi gjithë energjitë ,por në atë kohë na largoi vëmendjen nga shumë prioritete të tjera. Një moment tjetër i vështirë ishte ai kur kryetari Rugova me shumë kurajo informoi popullin e Kosovës se ishte diagnostifikuar me kancer të mushkërive. Ishte kuptueshme kjo dhe shkaktoi shumë shqetësime për shëndetin e kryetarit, por edhe për atë se çka nënkupton për të ardhmen e Kosovës. Vdekja e kryetarit Rugova në janar të vitit 2006 vetëm e shtoi shqetësimin për të ardhmen dhe më duket se të gjithëve na kujtohet java e zisë, reagimi i qetë dhe solemn të njerëzve që të gjithë u bënë bashkë pavarësisht besimeve të tyre politike, të gjithë u bashkuan për ta ndarë në ato ditë zie dhimbjen dhe respektin për atë që simbolizonte qëllimet dhe aspiratat e Kosovës dhe që fatkeqësisht, jeta e tij mori fund para realizimit të kësaj ëndrre, mirëpo sërish reagimi i shkëlqyeshëm i njerëzve të Kosovës.

Vdekja e kryetarit Rugova na çojë drejt një ndryshimi rrënjësor të udhëheqjes së Kosovës. Mirëpo më lejoni të theksoj serish se nganjëherë synojmë t'i harrojmë të gjitha këto procese që u kryen duke respektuar plotësisht rregullat dhe procedurat demokratike dhe ndodhen ndryshime në të tri institucionet demokratike. Këto ishin momente shumë të vështira, por me maturi demokratike dhe respekt për demokracinë ia dolëm .Kjo i impresionoi jo vetëm ata që ishin këtu, por edhe vendet në mbarë Evropën dhe botën, po ashtu besoj se nga ajo krizë dolëm me një rirforcim më të madh të procesit politik ,që u konfirmua para shtatë ditësh në Këshillin e Sigurimit. Për mua dhe besoj për të gjithë ju momenti më i rëndësishëm dhe fatmirësisht kjo nuk ishte vështirësi por ngjarje e mirëseardhur. momenti më i rëndësishëm ishte vendimi të fillonin bisedat për statusin përfundimtar. Nëse mund të jap një vështrim personal, moment i rëndësishëm ka qenë edhe emërimi i mikut tim të ngushtë Mati Ahtisari emisar për statusin. Në të vërtet kur kam ardhur në Kosovë para 2 vjetësh e kam bërë shumë të qartë se qëllimi dhe objektivi im kryesor ishin ta ndihmoja Kosovën të hynte në biseda për statusin e saj, për mua ishte e qartë se nuk mund të mbanim më gjatë një operacion të ndalur ,që është ajo që përcakton rezuluta 1244 dhe na duhej që të lëvizim për sqarimin e statusit. Për mua ky ishte prioriteti nr. 1 siç duhet të jetë edhe për ju. Sot kanë kaluar disa muaj e nga fillimi i procesit të të përcaktimit statusit dhe kemi besim të plotë se jemi disa muaj larg nga rezultati i procesit të statusit. Kam besim se statusi do të përcaktohet gjatë vitit 2006. Ahtisari ka besim në këtë, por për këtë kam edhe unë besim. Unë mendoj se një numër i madh shtetesh të Evropës dhe në SHBA e kuptojnë se vonesa e mëtejshme nuk është në interes të stabilitetit në rajon. Mendoj se të gjithë e dimë se rezultati i procesit të statusit duhet të jetë i pranueshëm për popullatën shumicë në Kosovë, por edhe njëherit dua ta shfrytëzoj këtë rast që t'u apeloj të gjithë ju që ta kuptoni, se siç dihet , statusi përfundimtar të jetë i pranueshëm për shumicën është përgjegjësi juaja,që në punën e përditshme të siguroheni se ky status do të jetë i pranueshëm edhe për popullatën pakicë. Kur kam ardhur këtu para 2 vjetësh kam përmendur edhe një varg prioritetesh të tjera. Kam thënë se duhet të gjejmë mënyrë për të caktuar prioritet procesin e standardeve. Ky proces ia ka marrë punën pothuaj të gjithëve, duke qenë të përqendruar në këtë, ne na duhej t'i prioritetizojmë procesin e statusit. Sot jam i kënaqur që kam mundësinë të them se është përshtypja ime që sot standardet shihen ashtu siç duhet të shihen. Standardet nuk janë mjete për të imponuar vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë,por standardet janë mënyrë për të ndërtuar atë lloj shoqërie në Kosovë që ju dhe fëmijët tuaj do të dëshironin të rriten dhe të jetojnë në të dhe sot nga të gjitha takimet nga qytetarët në Kosovë e ndiej se tani kjo gjë është kuptuar shumë drejt, prandaj secili qytetar ka interes që t'i kontribuojë këtij implementimi të standardeve. Sot po ashtu kuptohet qartë se standardet janë hapi i parë drejt integritit evropian dhe unë besoj se duke zbatuar standardet ,siç jeni duke e bërë tashmë, ju keni ndërmarrë hapat e parë të rëndësishëm drejt Evropës. Ju mund të thuani ,madje se kepi përparësi në këtë proces siç është konfirmuar edhe nga fakti se kemi një program të partneritetit evropian dhe se standardet janë pjesë integrale e këtij programi të partneriteti. Prioriteti i tretë që e kam përmendur kur kam ardhur të vazhdohet me transferet e përgjegjësive aq sa kishim mundësi, duke pasur parasysh kufizimet e mandatit, po ashtu edhe fleksibilitetin që e lejonte mandati. Është e qartë dhe ka qenë e qartë edhe atëherë se mënyra më e mirë që Kosova të përgatitë vetën për të marrë përgjegjësitë që do ta qesin gjendjen e Kosovës pas statusit, mënyra më e mira për t'u përgatitur është që autoritetet kosovare të jenë përgjegjëse dhe

të japin llogari për mendimet e tyre. Mendoj se është e drejtë nëse them se para 2 vjetësh ishte një ndjenjë se ishte UNMIK-u ai që i kishte përgjegjësitë kryesore dhe IPVQ-të kishin përgjegjësitë dytësore. Unë kam punuar shumë, ndoshta nuk kam pasur sukses, ndoshta kam pasur ,që ta ndërroj këtë rol, për mua ka qenë dhe është e qartë se janë IPVQ-të ato që janë përgjegjëse, janë Kuvendi, partitë politike, Qeveria, kryetari i Kosovës, duke pasur UNMIK-un me një rol mbështetës dhe në këtë gjendje mendoj se kemi marrë një varg hapash në drejtim të duhur për t'i ndërruar rolet në Kosovë.

Prioriteti i katërt që për mua lë në hije të gjitha të tjerat dhe që do të vazhdojë të zhvillojë çdo proces, është ekonomia, ajo është ende e vështirë, më gjithë progresit e arritur, privatizimi ka vazhduar me një shpejtësi impresive dhe të shpejtë. Ne kemi një kornizë makroekonomike solide dhe një bazë të mirë legjislative. Ne kohë të Fundit Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore e kanë pranuar menaxhimin e shëndoshë të ekonomisë nga autoritetet kosovare, mendoj se energjia sot njihet nga Banka Botërore dhe nga të tjerët si fusha kryesore e zhvillimit të ardhshëm ekonomik të Kosovës, por në të njëjtën kohë duhet të pranojmë se asnjë progres nuk ka pasur ndikim të madh në gjendjen në punësim, që duhet ta ketë. Kemi pasur shumë vështirë për të zvogëluar papunësinë, për të hapur vende të reja pune, ato janë hapur, por jo në atë masë që do të zgjidhte shqetësimet e një numri shumë të madh të njerëzve që jetojnë këtu. Statusi nuk është shkop magjik, por sipas mendimit tim duhet të synojë zhvillimin ekonomik dhe me hyrjen e investimeve të huaja do të shohim ndikim të qartë në punësim. Pa status apo me vonesën e statusit, vështirësitë ekonomike me të cilat ballafaqohen shumë njerëz në Kosovë ,do të vazhdojnë dhe kjo qartë do të përbëjë një bombë me orë, bombë sociale,që pas një kohe nuk do të jetë e mundshme të menaxhohet. Prioriteti i fundit dhe i pari që e përcaktova para 2 vjetësh ishte që të kontribuohet në ndërtimin e një Kosovë multietnike, më duhet të them se për këtë më vjen më së keqi, nuk mendoj se unë,apo ne së bashku, nuk kemi qenë në gjendje të bënim më shumë dhe të siguronim që pakicat në përgjithësi, edhe serbët e Kosovës në veçanti, për të ardhmen e tyre këtu. Kemi punuar shumë, kemi harxhuar mjaft kohë, por ndoshta nuk kemi qenë sa duhet të suksesshëm,mirëpo më duhet të them në të njëjtën kohë se ne nuk jemi ndalur. Nuk jam ndalur si pasojë e politikave jo shumë konstruktive të Beogradit në këtë aspekt. Në fillim kur kam ardhur i kam parë IPVQ-të si pa dëshirë për t'u shtrirë deri te serbët e Kosovës, tani shoh një shtrirje të dorës të të gjithë udhëheqësve, të qytetarëve të Kosovës tek serbët dhe kam thënë edhe në Këshillin e Sigurimit se kjo është shtrirje e sinqertë e dorës,që deri me tash tani nuk është është bërë reciprokisht edhe nga ana e serbëve të Kosovës, vetëm për faktin se ata ende po kërkojnë inkurajim për t'u angazhuar në procese nga Beogradi. Shpresoj se shumë shpejt serbët e Kosovës do të lirohen dhe do të jenë të lirë për të zgjedhur dhe zgjedhja për shumë nga ata do të jetë të bëhen pjesë integrale e kësaj shoqërie, ku kanë lindur. Unë llogaris në të gjithë ju që të vazhdoni ta shtirni dorën dhe të siguronit miqtë tanë serbë të Kosovës .Duke shikuar drejt së ardhmes shoh tri sfida të mëdha për Kosovën. Njëra është sundimi i ligjit. Kosova ende nuk është, por duhet të bëhet shoqëri e bazuar në sundim të ligjit, ka pasur suksese, me këtë rast mendoj se të gjithë duhet të jemi krenarë për punën efektive dhe impresive të Shërbimit Policor të Kosovës. Mendoj se kur bëhet fjalë për sundimin e ligjit duhet ta pranojmë kontributin e SHPK-së brenda mandatit të tyre, por në shumë mënyra duke bërë atë çka kanë bërë dhe mënyrën si e kanë bërë ata. Ata i kanë kontribuar edhe sundimit të ligjit. Mendoj se themelimi i ministrive të reja të Drejtësisë dhe të Punëve të Brendshme e ka vënë

përgjegjësinë për sundimin e ligjit aty ku duhet të jetë, sepse të gjithë e dimë se nga çdo shoqëri në botë se sundimi i ligjit duhet të ngritet brenda shoqërisë, ai nuk mund të imponohet nga jashtë dhe derisa secili qytetar i Kosovës të mos përkushtohet për sundimin e ligjit, të mos kontribuojë në mënyrën e tij për të ndërtuar shoqëri të bazuar në sundim të ligjit, sundimi i ligjit nuk do të vërë rrënjë në Kosovë. Secili qytetar dhe shërbyes publik duhet të shërbejë si shembull për sundimin e ligjit dhe të paraqes asi shembulli që do ta ndiqnin të gjithë qytetarët e Kosovës. Pa rrënjosjen e sundimit të ligjit demokracia nuk do të zhvillohet sa duhet, pa sundim të ligjit ekonomia nuk do të sundojë dhe në fund pa sundim të ligjit si bazë e çdo gjëje Kosova do të ketë vështirësi për të nisur krijimin e demokracisë, zhvillimin ekonomik dhe të gjitha ato që duam. Kemi bërë rrugë të gjatë, por të gjithë duhet ta pranojmë se sundimi i ligjit duhet të jetë sfida e parë. Sfida e dytë është ekonomia, kam folur për këtë. Unë ende mendoj se ju të gjithë e dini se ekonomia shumë e dobët është efekt shumë negativ për stabilitetin dhe është pengesë drejt pajtimit, themelet janë; statusi sigurisht se do të jetë një shtytës, por jo shklop magjik. Ne planifikojmë punësimin, por vetëm pas disa muajve të vështirë pas statusit do të shohim zhvillim të ekonomisë, porse të gjitha përpjekjet e udhëheqësve vendorë dhe mbështetja e bashkësisë ndërkombëtare duhet të jetë e përqëndruar më shumë se kurrë në ekonomi . Sfida e tretë e rëndësishme është që të ndërtohet një Kosovë e vërtet multietnike. Kosova ka qenë multietnike, është ende multietnike dhe Kosova duhet të mbetet e tillë. Në Evropën e sotme nuk ka vend për shoqëri që janë njëetnike dhe dua të apeloj në këtë fjalim timin të fundit që të bëni çdo gjë brenda mundësive tuaja që t'i risiguronit popullatat pakicë me veprime, me fjalë, me vizita, me biseda, t'i siguronit ato për të ardhmen tyre këtu. Çdo ditë do të ishte mirë t'ua shtrini dorën fqinjit tuaj. Unë kam besim të plotë pas takimit me shumë serbë të Kosovës se ata duan të rrinë këtu dhe natyrisht se ata duhet të rrinë aty, sepse këtu kanë lindur. Shpresoj se kjo do të ndodh, natyrisht në saje tuajën dhe me serbët e Kosovës që qëndrojnë këtu dhe pas statusit shpresoj se do të shohim kthime domethënëse. Shumë njerëz duan të kthehen, sepse memzi presin momentin dhe sinjalet e kthimit.

Më qe po largohem më lejoni ta bëjë më të qartë se kam besim të plotë që Kosova nuk do të dështojë në fakt kam shumë besim se Kosova do të ketë sukses, kam shumë arsye për këtë besim timin, por më lejoni që sot t'i përmendi dy më kryesorët. Siç kam thënë më parë personalisht e kam parë të kaluarën shumë të vështirë dhe çdo herë kam pasur më shumë respekt për këtë shoqëri, për njerëzit, për institucionet demokratike, për mënyrën e ballafaqimit , si i keni zgjidhur dhe si i keni kaluar ato teste, kam parë forcimin e demokracisë, rritjen e maturisë, po ashtu kam parë edhe rritjen e besimit në aftësitë tuaja për të tejkaluar krizën dhe për t'u fuqizuar nga vështirësitë. Për të gjitha këto arsye dhe me respektin tim të thellë që kam për njerëzit, për udhëheqësit e të tjerët ,kam besim të plotë se në duart tuaja Kosova do të jetë një shoqëri shumë e fortë.

Arsyeja e dytë e besimit tim për të ardhmen e Kosovës mbështetet në takimet e mija të shumta me njerëzit e zakonshëm të Kosovës. MË impresiononin thellë durimi i njerëzve të ballafaquar me shumë vështirësi sociale dhe ekonomike, mënyra si i përballonin vështirësitë ,më impresiononte shpirti i tyre i mirë, ky shpirt i tyre për mënyrën se si flasin, si mendojnë dhe si i ndajnë dashurinë , emocionet e tyre me të tjerët dhe kam qenë thellësisht i impresionuar nga pritjet shumë të mira dhe legjitime për një të ardhme më të mirë për Kosovën. Takimet e mia me njerëzit e viseve të mbarë Kosovën më kanë mbushur me gëzim, me besim për të ardhmen e Kosovës. Erdha këtu

t'u shërbeja kosovarëve .Tash këtë e konsideroj privilegj që më është dhënë kjo mundësi. Jam përpjekur të punoj sa më shumë për t'i shërbyer popullit të Kosovës dhe për të mos i zhgënjyer këta njerëz të mrekullueshëm të këtij vendi. Unë e di se qëllimi i popullatës shumicë është pavarësia dhe llogaris në ju që të siguroni se deri sa e realizoni ëndrrën tuaj që ajo të jetë ëndërr e të gjitha komuniteteve që realizimi i ëndrrës suaj të mos bëhet ankth për të tjerët.

Apeli im për ju, udhëheqës të Kosovës, përfaqësues të zgjedhur është që gjithmonë ta mbani mend se ne jemi shërbyes publik, ju jeni, unë jam shërbyes publik dhe jemi këtu që t'ju shërbejmë të tjerëve. Na është dhënë besimi që t'u besojmë të tjerëve dhe duhet të sigurohemi që çdo ditë me punën tonë ta respektojmë atë besim. Unë do të vazhdoj të punoj kudo që të jem, për njerëzit e Kosovës dhe përgjithmonë do të jem mik shumë i mirë i Kosovës. Dua t'ju falënderoj sot për partneritetin, për miqësinë dhe për besimin tuaj. Ju jeni në prag të një momenti të madh në historinë e Kosovës, mendimet dhe urimet e mia më të mira do të jenë me ju derisa e realizoni ëndrrën tuaj dhe derisa largohem duhet të keni besim se UNMIK-u do të qëndrojë këtu efikas si gjithmonë që t'ju mbështet plotësisht në punën tuaj dhe dua ta shfrytëzoj këtë rast t'i falënderoj edhe, se edhe nesër do ta kem një mundësi tjetër t'i falënderoj. Do të kthehem në Kosovë atëherë kur ëndërra juaj do të bëhet realitet . Pres me pa durim që t'i përjetoj ato çaste gëzimi me ju. Ju faleminderit!.

Duartrokitje në sallë

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Petersen në shikim të parë kjo është një dhuratë e vogël për një njeri të madh, por megjithatë është një dëshmi e historisë 6.000 vjeçare të një populli më të vjetër në Ballkan dhe ndër popujt më të vjetër në Evropë.

Duartrokitje.

Një pauzë 15- minutëshe për kafe .

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA

Deputetë të nderuar ju njoftoj se në sallë momentalisht janë 67 deputetë që do të thotë se janë plotësuar kushtet që të mund të fillojmë të punojmë. Gjithashtu, ju njoftoj se rendi i ditës, i propozuar nga Kryesia e Kuvendit, së bashku me materialin e nevojshëm ,u janë shpërndarë me kohë të gjithë deputetëve, andaj propozoj të fillojmë me pikën e parë. Fjalën e kërkon profesor Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI –Z. kryetar i Kuvendit, z. ministra, kolegë të çmuar. Dje pas dite në kanalet televizive të Kosovës kemi parë një pamje që unë do ta quaja të pakëndshme dhe rrëqethëse, një deputet koleg yni i Kuvendit të Kosovës është trajtuar dhunshëm nga Shërbimi Policor i Kosovës. Unë mendoj që kjo është një situatë për të cilën Kuvendi duhet të protestojë i tëri, kjo praktikë e trajtimit të tillë të papërgjegjshëm të deputetëve të zgjedhur të Kuvendit të Kosovës duhet të marrë fund përgjithmonë. Ky

nuk është rasti i parë, por ky është rasti më eklatant që ka ndodhur deri më tani. Kërkoj që Kuvendi haptas të protestojë për këtë sjellje dhe të kërkojë përgjegjësi dhe informacion për ndodhinë nga përgjegjësit e policisë së UNMIK-ut, nga përgjegjësit e policisë së Shërbimit Policor të Kosovës dhe direkt informatë nga ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës. Edhe një herë po përsëris, i zgjedhuri, përfaqësues i popullit të Kosovës duhet ta gëzojë imunitetin e përfaqësuesit në secilën situatë. Ju e dini fortë mirë që kjo ka ndodhur për shkak të një rebelimi ose mospajtimi të shtresave të shoqërisë sonë me ardhjen e kryeministrit të Serbisë në Kosovë, që pa marrë parasysh që ka deklaruar që e ka një leje të UNMIK-ut dhe do të vijë në procesin personal fetar, me të vërtetë e ka mbajtur një fjalim të ashpër politik. Pos kësaj edhe një herë u identifikua me kishën serbe si qendër politike. Unë nuk dua të gjykoj më tutje, por edhe një herë kërkoj që në formën e protestës Kuvendi të reagojë për deputetin Emrush Xhemajli.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka Xhevat Bislimi. Nëse e keni fjalën për rendin e ditës, atëherë e keni një minutë.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Z. kryetar, zotërinj deputetë, unë jam kryetar i Komisionit për Siguri. Kemi mbajtur një konferencë rajonale për siguri në Mitrovicë ditën e tretë më 27 të këtij muaji. Vizita është paraparë të bëhet në stacionin policor në veri të Kosovës. Në minutën e fundit na kanë thënë se nuk mund të bëhet vizita dhe jemi kthyer prapë. Të nesërmen, më 28 u garantua, u sigurua dhe u gjetën forca policore – ushtarake që të sigurohet ardhja e një kryetari të Qeverisë, Qeveri, popull dhe shtet përgjegjës për gjenocid dhe holokaust në Kosovë. Një vizitë e tillë e personaliteteve të larta të Serbisë mund të realizohej eventualisht vetëm pas 50 vjetëve në Kosovë. Edhe 2000 eshtra të njerëzve që ne po i quajmë për ta zbutur çështjen e të zhdukurve, të pagjetur etj, por janë viktimat të holokaustit serb vazhdojnë të vijnë në pako në Kosovë. Unë mund t'ju them këtu se vlerësimet që dolën dje nga kryetari i Komisionit për gjendjen në Mitrovicën e Veriut, nuk janë vlerësime të Komisionit, por vlerësime të tij personale, sepse gjendja në Mitrovicën veriore, në Kosovën veriore është e pandryshuar që 7 vjet, atje mungon lëvizja e lirë për qytetarët shqiptarë. Madje as ministri nuk mund të shkojë në vizitë atje, asnjë deputet nuk mund ta vizitojë atë pjesë të Kosovës. Kjo nuk do koment. Unë kërkoj nga ministri i Brendshëm dhe nga kryeministri që sot këtu të japë shpjegime që Kuvendi ta obligojë Qeverinë të marrë masa dhe ta ushtrojë kontrollin dhe mandatin e vet në tërë territorin e Kosovës. Dhuna që është ushtruar mbi ata djem që ne duhet t'i falënderojmë se ata bënë punën e institucioneve të Kosovës, në vend se institucionet e Kosovës ta pengonin ardhjen e kryeministrit të Serbisë në Kosovë, dolën disa djem që ta pengonin dhe me ta ishte edhe deputeti që e përshëndes për guximin e tij qytetar, që ne nuk e patëm atë guxim. Përkundrazi ai Vitrup dhe vitrupët e tjerë. së bashku me Qeverinë tonë ushtruan një dhunë të paparë mbi ata djem që kërkuan natyrshëm të drejtën e vetëvendosjes për popullin shqiptar, që shqiptarët të jetojnë të lirë, sikur mbarë populli i Kosovës, në demokraci dhe në liri të plotë. Nuk kishte asgjë të keqe, asgjë të dhunshme nga njerëzit që provuan të bëjnë detyrën e institucioneve që nuk po e bënin detyrën, ta ushtrojnë mandatin, prandaj edhe duhet urgjentisht të vihet para përgjegjësishë Qeveria, ministri i Brendshëm, por edhe vetë Kuvendi të dalë me qëndrime të caktuara për këto çështje shumë të nxehta politike dhe determinuese për të ardhmen e

Kosovës. Heshtja e mëtejme është vërtetë e pakuptimtë, është e pafalshme për Kuvendin, për Qeverinë dhe për të gjithë neve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Mendoj se deklarimi i z. Hamiti ishte i pranueshëm për të gjithë dhe do të ishte mirë me një votë formale ta miratojmë këtë.

Ishte propozimi për një reagim ose protestë të Kuvendit të Kosovës dhe mendoj se ishte me vend kjo. Shkojmë me një votë formale për propozimin e z. Hamiti.

Kush është për? Ju faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. Të përmbajtur. Nuk ka.

Konstatoj se në momentin e votimit kanë qenë prezent në sallë 79 deputet.

Vazhdojmë me pika të tjera të rendit të ditës.

Në ndërkohë pas aprovimit të rendit të ditës, respektivisht pas përcaktimit të rendit të ditës ka arritur një propozim nga Grupi parlamentar i LDK-së për propozimin e anëtarëve të Komisionit për rritjen e komisioneve parlamentare.

Fjalën e ka z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Në pikat e propozuara të rendit të ditës grupi jonë parlamentar i drejtohet Kuvendit për shqyrtim të pikës së 5 të rendit të ditës. Ne kemi konstatuar se kjo përmbajtje e këtij Projektligji është e përsëritur nga projektligjet e mëhershme, andaj kërkojmë një deklaram nga kryetari i Komisionit për buxhet dhe financa. Njëkohësisht në grupin tonë parlamentar, karshi kërkesës së Kryesisë së Kuvendit, bazuar në ndërrimet më të fundit të Rregullores së punës dhe shtimit të anëtarëve të Komisioneve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ne e kemi propozimin tonë për seancë plenare për 8 komisione nga 1 anëtar, ne e kemi miratuar këtë vendim si grup parlamentar dhe ju lusim që t'ia ofroni seancës plenare për votim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Fjalën e ka kërkuar deputetja Teuta Sahatçiu.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIA – Ju faleminderit z. kryetar. Normalisht që pajtohem me propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së, sepse është e drejtë dhe detyrë e tyre, por kemi një vërejtje të vogël. Në bazë të Rregullores së punës, rregulla 42 nën 1, ku bëhet fjalë për emërimin e anëtarëve të Komisionit, thuhet që ministri i Qeverisë nuk mund të jetë anëtar i një komisioni. Me shumë respekt ndaj zëvendësministrit Behxhet Brajshori, mendojmë që në qoftë se z. Brajshori është edhe zëvendësministër d.m.th. në pushtetin ekzekutiv edhe në pushtetin legjislativ, do të mund të merret si një përzierje e kompetencave. Kjo është vërejtja jonë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të PDK-së, a ka propozim.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputet. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka të drejtë të propozojë deputetë për dy komisione. Për Komisionin

për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, propozon Ramë Bujën, kurse për Komisionin për Bujqësi, Zhvillim Rural, Pylltari, deputeten Selvije Halimi.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Propozimin për pikën shtesë e hedh në votim.

Kush është për? Shumica absolute.

A ka kundër? Një

Abstenim , 2. Ju faleminderit!.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Fjalën e ka Naser Osmani.

DEPUTETI NASER OSMANI – Z. kryetar. Unë mendova se kur të vijë radha e pikës së 5-të të rendit të ditës do ta merrja fjalën, por po mendoj pas u shtua një pikë në rendin e ditës, ta marr tani fjalën. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur dje mbledhjen dhe njëzëri ka marrë vendim që t'i rekomandojë Kuvendit që Projektligjin për prokurimin publik t'ia rikthejë Qeverisë dhe ajo sa më parë ta dërgojë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit ekzistues, nr. 2000/17 në formë të amendamentuar e jo si ligj i ri. Ju faleminderit. Do të ishte mirë sikur të votonim , sepse kështu nuk mund ta trajtojmë si ligj.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Pasi është në rend dite kur të vijë radha do të debatohet për të.

Pasi kërkohet tërheqja e atij ligji do të duhet debat dhe të marrim vendim për të. Fjalën e ka z. Koci.

DEPUTETI GANI KOCI - Unë do të flas në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, por edhe si anëtar i Komisionit për Buxhet lidhur me vendimin që e ka marrë ky komision. Është shtruar nevoja e ndryshimit të ligjit ekzistues për prokurimin publik dhe në takimet që i ka pasur Komisioni ka shprehur gatishmërinë e bashkëpunimit për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji dhe pasi që ka pasur vendim të Qeverisë , ka ardhur propozimi, jo për plotësimin e ligjit, por për ndërrimin e tij në tërësi , ka ardhur një ligj komplet që quhet Ligji i prokurimit-publik. Esenca e ndryshimit është vetëm në 2 çështje e jo në krejt ligjin. Çështja e parë është se përjashtohen nga procedurat e prokurimit të gjitha ndërmarrjet publike që menaxhohen nga AKM-ja. Kjo ka qenë esenca e ndërrimit të këtij projektligji dhe ndryshimi tjetër është ,sepse sipas propozimit të ri krijohet edhe një mekanizëm tjetër që deri tash ka vepruar në kuadër të organit të Rregullatorit të Prokurimit Publik i ashtuquajtur Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave. Mendimet e Komisionit dhe propozimet e Qeverisë më parë kanë qenë të ndryshoheshin vetëm afatet, sepse ato i komplikojnë procedurat edhe punën rreth tenderimeve në përgjithësi.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Koci e kemi në rend dite dhe atëherë do ta keni fjalën për këtë.

DEPUTETI GANI KOCI – Ju lutem ,u propozua që të hiqet nga rendi i ditës dhe po i jap arsyetimet pse duhet të hiqet nga rendi i ditës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Do të debatohet kur të vijmë në këtë pikë.

DEPUTETI GANI KOCI – Ne nuk do të debatojmë ,sepse po kërkohet të hiqet komplet dhe të vijë në formën e amendamentimit ,atje ku ka nevojë të plotësohet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Nëse tash e heqim nga rendi i ditës, duhet të vijë në seancën tjetër, prandaj po them se kur të vijmë në këtë pikë të rendit të ditës,do të bisedojmë për këtë çështje dhe do të marrim vendim për të. Ju lutem , shkojmë me radhë.

Fjalën e ka Nazim Jashari.

DEPUTEETI NAZIM JASHARI – Ju përshëndes z. kryetar. Mendoj se propozimi i Naserit ishte konform Rregullores së punës së Kuvendit. Në qoftë se thuhet që në çdo moment të seancës një deputet mund të çohet të propozoj që një pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës ose të shtohet siç ndodhi pak më parë, atëherë Kuvendi duhet të deklarohet me votë lidhur me propozimin e deputetit në fjalë. Prandaj z. Osmani e ka përkrahjen e plotë të Komisionit lidhur me këtë çështje. Në komision kemi diskutuar me një unitet dhe kemi ardhur në përfundim që kjo pikë nuk duhet të trajtohet sot në këtë seancë. Është punë e Qeverisë që të punojë më tutje me të dhe të na sjellë në mënyrë, siç është më së miri edhe për këtë Kuvend që po miraton ligje dhe që ato ligje nuk duhet t'i shpallë të dështuara ende pa u jetësuar mirë, por duhet të përmirësohen ato gabime ,siç janë marrë parasysh. Mendoj se propozimi ishte shumë konkret dhe se Kuvendi duhet të deklarohet lidhur me propozimin e z. Osmani. Mendoj se duhet të votohet dhe ecim tutje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Mungon incizimi

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit deputete dhe duhet të veprojmë kështu, të mos keqpërdoret mirësia ime ndaj secilit. Fjalën e ka z. Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Mua më vjen keq të flas për këtë problem në mesin e të gjithë këtyre juristëve,ndër të cilët edhe kryetari i Kuvendit është jurist. Të gjitha kërkesat janë që pika 5 të mos shqyrtohet sot dhe në kuptimin e të gjitha rregullave në fuqi ajo mund të shtyhet. Mirëpo, juridikisht shtyrja nuk zgjedh asgjë, vetëm e largon edhe për një mbledhje për t'ia kthyer Qeverisë ne duhet të debatojmë dhe t'ia kthejmë me arsyet, për ndryshe ne nuk kemi bërë asgjë veç e heqim dhe pas dy javëve jemi në të njëjtën pikë. Nëse nuk është kështu ju jeni juristë. thujeni fjalën tuaj. Ju faleminderit!.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës së 15 qershorit 2006.

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 15 qershor 2006 u është shpërndarë deputetëve dhe dihet procedura .Nëse ka vërejtje mund t'i paraqesin me gojë apo me shkrim në mënyrë që të inkorporohen në procesverbalin që në seancën e ardhshme do ta keni të kompletuar.

Nëse nuk ka, konstatoj se seanca plenare e miratoi procesverbalin e seancës plenare të 15 qershorit 2006.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Pyetjet e deputetëve.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës së Kuvendit koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta maksimumi. Patëm shumë apo pak pyetje nuk mund ta kalojmë këtë kohë, prandaj keni kujdes kur të merrni fjalën për të pyetur. Konform rregullës 26.2 këtë mundësi e kanë shfrytëzuar 8 deputetë nga mbledhja e kaluar si dhe 4 pyetje pa përgjigje nga seanca e kaluar, për shkak se nuk kanë qenë prezentë ministrat që u janë drejtuar pyetjet. Pyetjet e deputetëve u janë dërguar me kohë kryeministrit, ministrave ,si dhe u janë shpërndarë të gjithë deputetëve. Ju njoftoj se koha për pyetje zgjatë një minutë, përgjigja e ministrit deri në 3 minuta, pyetja plotësuese 1 minutë dhe përgjigja plotësuese 2 minuta.

Fjalën e ka deputeti Emrush Xhemajli

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabineti qeveritar. Unë nuk e mora fjalën më parë. Ju falënderoj z. Hamiti dhe të gjithë juve. Atë që desha ta them është një pyetje për ministrin e Rendit. Kur t'i ftojë UNMIK-u armiqtë e Kosovës le t'i mbrojë vetë e jo me djemtë e Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. Xhemajli, një sqarim dhe mund të vazhdosh pastaj. Pyetjet janë marrë brenda seancës, është dashur të bëhen përpara me shkrim dhe prej djeshit ka pasur mundësi të bëhet ajo.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI - Të gjitha institucionet e Kosovës publikisht janë shprehur kundër ardhjes së Koshtunicës në Kosovë. Shërbimi Policor i Kosovës dihet se buxhetin e ka nga Kuvendi i Kosovës. Pyetja është: "Kush e ka urdhëruar Shërbimin Policor të Kosovës që të intervenojë kundër protestuesve në Merdar dhe në Mitrovicë dhe si shtesë, Kur do të ndërpriten torturat pasi që të arrestohen njerëzit, sepse e kuptoj se gjatë intervenimit mund të ketë lëndime etj, nuk është ajo me rëndësi edhe ajo e ka vleftën e vetë, kjo është me rëndësi. Në stacionin policor të Prishtinës janë rrahur disa djem në prezencën time". Ju faleminderit. Kjo është pyetja për ministrin e Rendit.

Pyetja për ministrin e Drejtësisë. Ardhja e udhëheqjes serbe në Kosovë po dihet se ka qenë politike. Arrestimet kanë qenë politike dhe ende janë njerëzit në arrest. Pyetja për ministrin e Drejtësisë: “Me cilin ligj dhe me cilin nen të ligjeve të Kosovës mbrohet Serbia në Kosovë, përkatësisht të pandehurit për krime, pa kurrfarë pajtimi vijnë në Kosovë dhe nëpërkëmbin dinjitetin e qytetarëve të Kosovës”. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Nëse ministrat janë të përgatitur për pyetjet që u shtruan, mund të përgjigjen tash, nëse jo, vazhdojmë me pyetje të tjera, por pyetja mbetet për seancën e ardhshme.

Radha e pyetjeve shkon kështu: Deputeti Ferid Agani, për ministrin Shatri ka pasur nga mbledhja e kaluar një pyetje.

Ministri Shatri jeni gati. Urdhëroni!

MINISTRI HAKI SHATRI – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, Pyetjes së deputetit Agani që ka bërë më 21.6.2006, nuk kam mundur t’i përgjigjen në seancën e kaluar për arsye se kam qenë i angazhuar në Bordin e AKM-së. Kjo seancë e caktuar një muaj më parë, por për mungesën time i kam informuar organet kompetente të Kuvendit, megjithatë kërkoj falje që nuk kam qenë javën e kaluar edhe pse me arsye dhe për këtë kam këtë përgjigje: “Në vitet e mëparshme buxhetore dhe në këtë vit puna e kujdestarisë paguhet në bazë të udhëzimeve administrative. Kjo kategori e pagesës, pra kujdestaria nuk është e paraparë të paguhet nga kategoria e rregullt e pagave dhe e mëditjeve, por pagesat e tyre bëhen nga të hyrat vetjake, pra nga participimet që bëjnë klientët për shërbimet që i shfrytëzojnë në institucionet shëndetësore. Në vitin 2006, po flas për këtë vit, pagesa e kujdestarisë bëhet në bazë të udhëzimit administrativ nr. 4/2006. Me udhëzimin administrativ të kësaj date është caktuar edhe çmimorja e re e participimeve për shërbimet shëndetësore, e cila mendohet se do të sigurojë fonde të mjaftueshme për pagesën e kujdestarisë. Gjithashtu edhe në bazë të dokumenteve buxhetore që janë në përgatitje e sipër për buxhetin e vitit 2007 dhe në bazë të dokumentit, korniza afatmesme e shpenzimeve për 2 vjetët pasues 2008 dhe 2009 nuk parashihet që kujdestaritë të bëhen në institucionet shëndetësore të paguhet nga kategoria e pagave, por kjo kategori do të vazhdojë të rregullohet me udhëzim administrativ. Dua t’jua përkujtoj se kategoria e të hyrave vetjake, pra kjo që është caktuar si bazë për pagesën e kujdestarive dhe sipas ligjeve në fuqi, janë të hyra publike dhe ligji për menaxhimin e financave publike obligon institucionet gjegjëse që t’i evidencojnë dhe të raportojnë të gjithë të hyrat, që bëhen nga ky burim i të hyrave si dhe shfrytëzimi i tyre. Unë, sa për t’u paraqitur argument po bazohem në nenet 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9. vetëm një fjali, pra me udhëzimin administrativ në mënyrë recidive është e rregulluar mënyra e formimit dhe e shfrytëzimit të mjeteve si dhe mënyra si paguhet pra kujdestaritë e rregullta, kujdestaritë jashtë orarit të rregullt të punës, është një udhëzim administrativ që është nënshkruar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri për Ekonomi dhe Financa. Ju faleminderit! Në qoftë se ka nevojë për sqarime, unë jam këtu.

KRYETARI I KUVENDIT – KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ferid Agani, a keni mjete plotësuese?.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar. – Fillimisht them se bëhet fjalë për udhëzime administrative 6.2006 jo 4/2006 dhe pyes ministrin e Ekonomisë a e konsideron se me këtë udhëzim është bërë shkelje e obligimit ligjor që punëtorëve shëndetësorë t'u paguhen puna e detyruar me ligj. Neni 27. paragrafi 3 i Ligjit për Shëndetësi i obligon punëtorët shëndetësorë të punojnë gjatë natës dhe nuk mund dhe është e palejueshme dhe nuk mund të pranohet që pagesa e punës së tyre të bëhet nga të hyrat e tyre vetjake. Kjo është njësoj sikurse të paguhen policët për punën gjatë natës, varësisht prej asaj se sa do të dënojnë vozitësit në komunikacion. Mendoj se ka ardhur momenti kur ndaj punëtorëve shëndetësorë të silllemi në mënyrë të përgjegjshme dhe t'i respektojmë dispozitat ligjore. Nuk mund ta obligojmë me ligj dikë të punojë dhe pastaj ta paguajmë, varësisht prej asaj se sa mjete do t'i grumbullojnë ata vetë. .

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Ministër, dy minuta i keni kohë. Nuk do të vazhdojmë

MINISTRI HAKI SHATRI - Unë thashë që të hyrat vetjake të organizatave buxhetore janë të hyra publike, kurse dhe organizatat buxhetore janë të obliguara që të hyrat t'i evidencojnë dhe t'i raportojnë Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave , kurse me udhëzim administrativ është rregulluar decidivisht mënyra e kompensimit të punëtorëve shëndetësorë, që punojnë punë plotësuese jashtë orarit, në ndërresat e natës dhe të tjera. Unë edhe një herë po ju ftoj ta shfrytëzoni udhëzimin administrativ nr. 4/2006. Tek unë është udhëzimi nr. 4, nuk di nëse keni pasur ju ndonjë dokument tjetër, por unë e kam para vetes këtë udhëzim. Është i nënshkruar nga dy ministrat. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Deputetja Safete Hadërgjonaj ka shtruar pyetjen në mbledhjen e kaluar, nuk ka marrë përgjigje. Z. ministër jeni gati të përgjigjeni . Ministër Shatri, urdhëroni, natyrisht keni tre minuta kohë

MINISTRI HAKI SHATRI – Ju faleminderit z. kryetar. Pyetja e deputetes që ishte: Sa është numri i bizneseve të regjistruara dhe sa prej tyre kanë paguar obligimet tatimore sipas rregullave në fuqi.

Ju lutem, unë nga kanalet zyrtare kam marrë këtë pyetje dhe e kam përgatitur përgjigjen e kësaj pyetjeje. Në qoftë se ka pasur tjetër pyetje, unë atëherë pres ta marr pyetjen me rrugë zyrtare dhe t'i përgjigjem, por nuk është faji im. Kur jemi këtu, besoj se duhet të kihet parasysh. Unë po them se këtë pyetje e kam marrë dhe për këtë pyetje jam përgatitur të përgjigjem. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – E kemi pyetjen më vonë, për atë që po thoni ju

Haki Shatri – Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Deputeti Hydajet Hyseni e ka marrë përgjigjen e pyetjes. E keni radhën më vonë, po them, pikërisht për atë po them edhe unë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Por ministri deklaroi se nuk e ka marrë këtë pyetje tuajen . Mbetet përgjigja për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit.

Pyetja nga seanca e kaluar do t'i përcillet në seancën e ardhshme ministrit për përgjigje.

Hydajet Hyseni e ka marrë përgjigjen nga zëvendëskryeministri Haziri . Ka një pyetje.
Urdhëroni z. Hyseni

DEPUTETI HYDAJET HYSANI - Ju faleminderit. Z. kryetar. Zonja dhe zotërinj deputetë. Veçanërisht ju të nderuar z. të regjisë se ju në fund po e vendosni kohën. Kam një propozim ,së pari që të rregullohet çështja e foltore. Për pyetjet parlamentare propozoj të jenë dy foltore: për deputetët dhe për ministrat. Kam një vërejtje për renditjen e pyetjeve. Me Rregullore, renditja e pyetjeve duhet të bëhet sipas kohës kur janë dërguar. Unë nuk do ta lexoj pyetjen meqë e kamë lexuar herën e kaluar, por megjithatë do të dëshiroja të theksoj se pyetja është bërë një vit më parë. Megjithatë përgjigjen e kam marrë, por mendoj se përgjigja duhet t'u drejtohet qytetarëve. Këtë pyetje unë e kam bërë në emër të qytetarëve se ata kanë kërkuar nga unë ta bëj këtë pyetje. Prandaj kërkoj që pyetja lexohet, le të mundësohet që të lexohet dhe përgjigja të jepet publikisht. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni Nazmi

ZËVENDËSMINISTËR- NAZMI FEJZA - Konform shkresës së arritur nga Kuvendi i Kosovës më 13.6.2006, që ka të bëjë me pyetjen parlamentare të deputetit Hydajet Hysenit, të parashtruar më 8. gusht 2005, në lidhje me gjendjen e të zhvendësuarëve dhe të shpërngulurve nga komunat e Preshevës, Medvegjes dhe të Bujanocit, të vendosur në Kosovë dhe çka kanë ndërmarrë Qeveria dhe Ministria përkatëse për zgjidhjen e problemit. Ministria për Komunitete dhe Kthim thotë si vijon: Prej momentit të formimit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, shërbimeve të saj asnjëherë dhe në asnjë rast nuk u ka arritur asnjë kërkesë për ndihmë nga asnjë qytetar i komunave në fjalë të vendosura përkohësisht në Kosovë, Ministrisë, gjithashtu, nuk i ka arritur asnjë kërkesë nga komunat, do të thotë nga pushtetet lokale ku janë të vendosur këta qytetarë përkohësisht. Nga ana tjetër, Ministria për Komunitete dhe Kthim e sheh të nevojshme t'ia përkujtojë z. Hyseni se nuk është në përgjegjësinë e Ministrisë t'i pres, t'i vendosë dhe të përkujdeset për qytetarët që në forma të ndryshme vijnë nga vendet e tjera, por në përgjegjësinë tonë është t'i kthejë qytetarët e zhvendosur nga trojet e tyre të origjinës, që pa dëshirën e tyre janë shpërngulur. Ende te ta ekziston vullneti për t'u kthyer, për ta pranuar realitetin e ri të krijuar dhe për t'u ballafaquar me sfidat me të cilat ballafaqohet përgjithësisht popullata ekzistuese në Kosovë.

Stafi menaxhues i Ministrisë është i hapur. Ka kapacitete të përgatitura profesionalisht për të pranuar edhe përgjegjësitë edhe kompetenca të reja, pra edhe të natyrës, për çka është shtruar pyetja, por për këtë duhet të pasojë vendimi i shoqëruar me buxhet adekuat. Duke potencuar edhe një herë faktin se Ministria për Komunitete dhe Kthim, me punën e saj të deritanishme ka dëshmuar në praktikë për angazhim për kthimin e qytetarëve të Kosovës ,pavarësisht nga përkatësia fetare dhe kombëtare, unë falënderoj në emër të

Ministrisë deputetin për pyetje, mirëpresim pyetjet edhe nga deputetët e tjerë, por edhe nga qytetarët në çdo moment. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Z. Ministër e keni një pyetje nga Hydajet Hyseni nga mbledhja e kaluar. A jeni i disponuar të përgjigjeni tani? Urdhëroni z. Hyseni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Së pari unë prita, meqë u përmend përgjigja për pyetjet tjetër, por megjithatë unë e falënderoj ministrin për përgjigjen, do ta falënderoja edhe ministrin Petković që ka marrë nismën edhe për të kontaktuar drejtpërdrejt edhe për qasjen e tij gjithëpërfshirëse të çështjeve të zhvendosurve - refugjatëve, por vërejtja ime dhe do ta shfrytëzoj rastin të theksoj se koncepti ,me të cilin është ndërtuar Qeveria dhe Ministria, kurse pyetja ime u është drejtuar Qeverisë dhe Ministrisë përkatëse, është e njëanshme dhe është Ministri për Komunitete dhe Kthim jo vetëm për kthim të një komuniteti. Prandaj, dëshiroj të shfrytëzoj rastin për të theksuar defektin e madh, po trajtohen probleme të njëjta me standarde të dyfishta, po trajtohen qytetarët që janë në gjendje të njëjtë me standarde të dyfishta dhe për pasoj një palë po diskriminohet keq, megjithatë një ekuivalencë ndërmjet qytetarëve të Preshevës dhe qytetarëve të tjerë në Kosovë dhe vetë problemi i Preshevës dhe problemet e tjera që ekzistojnë në Kosovë, është jo i vetmi

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- z. Hyseni do të dëshironi ta përsëritni pyetjen nga mbledhja e kaluar për ministrin Haraqija, apo ndoshta nuk ka nevojë ta përsëritni, sepse sigurisht ministri e ka pyetjen. Urdhëroni z. ministër

MINISTËR ASTRIT HARAQIJA – I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë. Duke marr shkas nga pyetja e deputetit Hydajet Hyseni, të parashtruar në seancën e Kuvendit të Kosovës më 13 qershor 2006 në lidhje me përpjekjen e Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sportit dhe çështjeve jo rezidente për zgjidhjen e problemeve, me të cilat përballen qytetarët e Kosovës që jetojnë dhe punojnë në vendet e ndryshme të Evropës dhe të botës, mund të konstatoj se në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ekziston Departamenti i Çështjeve Jorezidente që në radhë të parë merret me mbajtjen dhe ruajtjen e kontakteve me qytetarët e Kosovës në mërgim. Në këtë kuadër edhe në politikat programore të Ministrisë, përkatësisht të Departamentit përkatës kemi paraparë t'i ruajmë dhe t'i vazhdojmë lidhjet tona me njerëzit tanë jashtë Kosovës ,kur dihet kontributi i tyre deri me tash. Këto lidhje kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen dhe me organizimin e manifestimeve të ndryshme kulturore. Edhe në takimet tona me ta, që nuk janë të rralla, janë shtruar edhe shqetësimet rreth zgjidhjes së statusit të tyre juridikë, por dihet sa janë kompetencat e Qeverisë së Kosovës. Ne pavarësisht që nuk është kompetencë jona regjistrim dhe pajisja me dokumentacione personale siç janë: letërnjoftimet apo dokumentet e udhëtimit. Në bashkëpunim me Ministrinë e Shërbimeve Publike në atë kohë dhe tash me Ministrinë e Punëve të Brendshme, kemi bërë çdo gjë të mundshme që këto të mos presin bashkatdhetarët tanë me radhë siç ka ndodhur më parë, por tani do të zgjasin vetëm 7 ditë të gjitha procedurat. Ne si Ministri insistojmë që të shkurtohen procedurat

burokratike në të gjitha aspektet. Këto procedura tash edhe procedurat e tjera dihet që janë kompetencë e rezervuar e administratorit. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër. Pyetje plotësuese sigurisht. Z. Hyseni, një minutë e keni

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Falënderoj për përgjigjen, megjithatë mendoj se përgjigja duhet të ketë edhe pjesë tjera, të cilat i presim në forma të tjera, i presin qytetarët tanë që janë jashtë e që është çdo i treti ekonomikisht është edhe më shumë se kaq dhe veçanërisht lidhur me problemet e informimit të tyre, që lidhen me udhëtimin e tyre dhe me kthimin dhe riatdhesimin. Po e theksoj edhe një herë, koncepti i Qeverisë që i ndan qytetarët dhe ata që janë jashtë Kosovës nëpër ministri të ndryshme dhe i kategorizon ndryshe, duhet rishikuar se a është i gabuar, është njëfarë aparteidi le të jetë edhe pozitiv, si po na pëlqen ta quajmë, por sido që të jetë, është defekt. Qytetarët duhen trajtuar njëjtë. Mërgatës i kemi më shumë borxh, veçanërisht pres përgjigje për revistën “Ura”, ajo është përmendur si një nga sukseset e institucioneve të Kosovës disa në raportet e Sekretarit të Përgjithshëm, kurse ka një vit që nuk botohet. Kam qenë njëri nga themeluesit e saj dhe kam të drejtë plotësuese për të kërkuar.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Urdhëroni z. ministër

MINISTRI ASTRIT HARAQIJA – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë. Unë thashë më parë se i kemi borxh mërgatës të gjenerata jonë që jemi nga 34 -vjeçar, po nga vitet 68-ta që i ka financuar të gjitha aktivitetet dhe ato të vitit '81 dhe ato të vitit '90 deri '99 dhe sot që vazhdojnë investimet për Kosovën. Mirëpo dihet që nuk është kompetencë e Qeverisë, por e administratës së UNMIK-ut. Sa i përket revistës “Ura” unë jam ai që e kam ndërprerë për arsye se buxheti në vitin 2004 ka qenë 9 milion për Ministrinë e Kulturës, kurse sot në vitin 2005-2006 është 6 milion. Duhet ta kuptojmë se tashmë kanë kaluar kohët e fletushkave, tash është koha e internetit. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit z. ministër. Vazhdojmë më tutje. Deputeti Xhevat Bislimi, nga seanca e kaluar ka bërë një pyetje për ministrin Gjini. Kjo ka ndërlidhje me interpelancën që ta bëjë në të ardhmen.

Deputeti Naser Osmani, andaj mbetet për seancën e ardhshme.

Ministri insiston se nuk është e njëjtë. Doni të përgjigjeni tash ? Fjalën e ka ministri Gjini në pyetjen e deputetit Xhevat Bislimi

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryetar, z/kryeministër, kolegë, ministra, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës. Pyetja të cilën e kam marrë unë ka të bëjë me fshatin Hade, me zonën e rrezikshmërisë, E kam marrë pyetjen nga Selvije Halimi. Nëse do të flasim për këtë pyetje, kjo nuk ka të bëjë me interpelancën, që është lënë për fund të kësaj seance. Atëherë unë nuk kam marr pyetje tjetër përveç kësaj, z. kryetar, kjo është pyetja që e kam marrë , ndërsa për interpelancë ka mbetur në fund të seancës edhe pse e kemi kërkuar disa herë që të mos na mbani gjithë ditën këtu edhe të jenë përgjigjet tona në fund për shkak se munda shkon kot për shkak se të gjithë e dini

se ministrat duhet të jenë në punë edhe një ditë të dëgjojnë është shumë gjatë. Zoti kryetar, a duhet të përgjigjem në këtë pyetje apo të pres?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Përgjigju pyetjes së Xhevat Bislimit.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit! Do të përgjigjem kësaj pyetjeje.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Jo pyetjes së Xhevat Bislimit. Pyetja është nga seanca e mëparshme. Ju nuk e keni marrë sigurisht atë pyetje. Mirë, në rregull. A dëshiron deputeti Xhevat Bislimi ta përsëritë pyetjen? Urdhëroni!

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Pyetja ime ka të bëjë me menaxhimin e ujërave nga Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit dhe me mbrojtjen e ambientit nga ndotja tepër e madhe nga mbeturinat, sepse proskat dhe lumenjtë e Kosovës janë shndërruar në njëfarë mënyre në deponi mbeturinash që pastaj shkaktohen vërshime të jashtëzakonshme ,siç është rasti në komunën e Vitisë, që për dy – tri vjet me radhë ka pasur vërshime dhe dëme shumë të mëdha që u janë shkaktuar bujqësisë dhe bujqve të asaj ane, por deri më sot këto ministri edhe pse kanë premtuar të ndërmarrin diçka në këtë drejtim, nuk kanë ndërmarrë asgjë për kompensimin e dëmeve ose për hapjen e kanaleve-pirroskave e të lumenjve që vërshuan nga mbeturinat dhe kështu vazhdojnë ta ndotin dhe helmojnë edhe tokën bujqësore edhe ambientin edhe çdo gjë. Prandaj, pyetja ime çka u ndërmor lidhur me këtë?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Unë thashë në fillim që kjo mund të lidhet me interpelancën, që do të jetë më vonë, prandaj vazhdojmë më tutje. Pyetjet e reja që janë drejtuar për këtë seancë. Tani , po them se procedura është duke shkuar shumë në rregull, pavarësisht se a i pëlqen dikujt apo jo.

Deputetja Safete Hadërgjonaj ka një pyetje për kryeministrin Çeku. Zëvendëskryeministri paraqitet për përgjigje. Urdhëroni z/kryeministri

ZËVENDËS KRYEMINISTËRI LUTFI HAZIRI - Kush i ka caktuar pagat e tyre dhe të Komisionit ...

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Zëvendëskryeministër z. Haziri, po e bënë pyetjen. Pritni pak. Urdhëroni deputetë!

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Unë kisha një pyetje për z. kryeministër. Çështja është: pagesa e anëtarëve të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik. Në mbështetje të nenit 81 të Ligjit të prokurimit publik, Qeveria e Kosovës e ka themeluar -Komisionin Rregullator të Prokurimit Publik, kryetarët dhe anëtarët e Bordit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik janë emëruar nga Kuvendi, janë propozuar nga Qeveria dhe emëruar nga Kuvendi i Kosovës me 31 janar të vitit 2005. Pyetja ime është: Kush i ka caktuar pagat e tyre dhe në çfarë baze ligjore?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni zëvendëskryeministër

ZËVENDËSKRYEMINISTËRI LUTFI HAZIRI – I nderuari kryetar, të nderuar deputetë, e nderuara deputete Hadërgjonaj

Më themelimin e Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik dhe me emërimin e shkarkimin, statusi i anëtarëve të këtij komisioni rregullohet me nenet: 81, deri 89 të Ligjit të prokurimit publik të Kuvendit të Kosovës nr. 2003/17, i shpallur nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nëpërmjet Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2004/3 të datës 9. shkurt 2004. Mirëpo, Ligji për prokurim publik nuk jep përgjigjen të pyetjes se kush e cakton pagën e anëtarëve të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik, sepse mu për këtë çështje mungojnë dispozitat përkatëse të ligjit në fjalë. Pasi që mungojnë dispozitat e veçanta për Ligjin e prokurimit publik, zbatohen dispozitat e përgjithshme për Shërbimin Civil të Kosovës. Sipas nenit 86.2 të Ligjit për prokurim publik, anëtarët e Komisionit Rregullator për Prokurim Publik kanë status të nëpunësve civilë, ndërsa sipas nenit 16 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2003/2, që e zbaton Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për shërbimin civil të Kosovës, pagat në shërbimin civil i cakton Ministria e Shërbimeve Publike me miratimin e Qeverisë së Kosovës. Nga kjo rezulton kompetenca e Qeverisë, përkatësisht e Ministrisë së Shërbimeve Publike për t'i caktuar pagat e anëtarëve të Komisionit rregullator për prokurim publik. Pas emërimit të anëtarëve, nga Kuvendi i Kosovës, me vendim të datës 30 korrik 2004, nuk ka qenë e mundur që Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik të fillojë punën pa u përcaktuar paga e anëtarëve të Bordit të tij. Vendimin për këtë çështje e ka marrë më. 15 prill 2005, Bordi i Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik me miratimin e ministres të Shërbimeve Publike dhe me vendim të datës 20 maj 2005, këtë çështje e ka rregulluar ministria përkatëse. Unë e shoh të nevojshme, që në emër të Qeverisë, jo vetëm rregullimi i pagave të anëtarëve të Bordit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik, por edhe të të gjithë anëtarëve të organeve publike, të përcaktohen me Ligjin për prokurim publik, që e përmend si shembull edhe Agjencinë për Prokurim Publik ta ketë një bazë të qartë ligjore në Ligjin për prokurim publik, që pritet sot të diskutohet nga ana juaj. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Keni pyetje plotësuese? Urdhëroni! Keni një minutë. Hadërgjonaj ka një pyetje, një minutë pyetje plotësuese

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Z. Zëvendëskryeministër, më vjen mirë që e përcaktove statusin e Bordit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik, sepse me pagën që e marrin ata shpesh krijohen dilema se mos janë staf politik a ku ta di unë, meqenëse ata paguhen nga 1075 €. Unë të lus të tregosh se a ka koeficient? Sipas cilit koeficient është miratuar kjo pagë, sepse në stafin civil sipas bazës ligjore, sipas rregullativës ligjore nuk ka ndonjë koeficient, që e bënë pagesën prej- mbi 1000 €. Prandaj, me qenë se këta faktikisht ia kanë caktuar pagën vetvetes dhe vazhdojnë ende të paguhen, çka keni ndërmarrë ju që të përmirësoni këtë çështje pas zgjedhjes suaj, meqenëse është e kundërligjshme dhe shkelje ligjore?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni kryeministër

ZËVENDËSKRYEMINISTËRI LUTFI HAZIRI- Ju faleminderit! Unë dëshiroj të konfirmoj edhe një herë se përcaktimin e pagës së anëtarëve të Bordit e ka bërë Qeveria e Kosovës sipas propozimit të Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe jo vetëm ky bord, por të gjitha bordet e Kosovës dhe agjencitë kanë koeficient të veçantë, të dallohen nga pjesa tjetër, me pjesën më të madhe të shërbyesve civilë. Koeficientin unë do të mund ta konfirmoja vetëm në seancën e ardhshme si cila është baza e saj, ndërsa sa u përket hapave të ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e parafundit të saj ne kemi marrë vendim, që parasheh riorganizim dhe ristrukturim të të gjitha bordeve, agjencive dhe autoriteteve rregullatore brenda institucioneve të Kosovës, që përfshinë edhe dy borde që janë emëruar nga ana juaj: Bordin për Prokurim dhe Bordin për Telekomunikacion, që duhet të raportojnë dhe në bazë të rezultateve të punës dhe të angazhimit të tyre duhet t'i kalojnë procedurat e emërimeve dhe të rrimërimeve në Qeveri, respektivisht në Parlamentin e Kosovës, për shkak të vetmit qëllim të bazuar se jemi të interesuar t'i rritim efektivitetin dhe profesionalizmin në organet bartëse të politikave ose të kontrollit ose të politikave të Qeverisë dhe të institucioneve që i bartin sipas ligjit. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Berat Luzha ka pyetje për kryeministrin Çeku. Urdhëroni z. Luzha, doni ta përsëritni pyetjen apo?

DEPUTETI BERAT LUZHA – Zoti kryetar, nga shtatori i vitit të kaluar e kam bërë një pyetje parlamentare, që ka të bëjë me Ligjin për lojërat e fatit, që është pezulluar në prill të vitit të kaluar dhe prej atëherë Sektori i lojërave të fatit funksionon pa ligj dhe është krijuar një anarki dhe një vakuum ligjor që ka mundësuar pastaj edhe keqpërdorimet në këtë fushë. Kërkoj që, në seancën e radhës kryeministri të vijë dhe t'i përgjigjet kësaj pyetje, sepse me interes të veçantë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Ramadan Kelmendi i ka dy pyetje, po ashtu për kryeministrin. Meqenëse Kryeministri nuk është këtu, doni të përcillet për mbledhjen e ardhshme apo do të merrni përgjigjen nga zëvendëskryeministri? Nuk janë marrë vesh. Shkojmë më tutje. Po ashtu ka pyetje për Kryeministrin Çeku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. Kryesues, pyetja është e drejtuar z. Kryeministër lidhur me – se pyetja është: cili është qëndrimi i Qeverisë lidhur me kohëzgjatjen e pushimit të lehonisë dhe kompensimit material për këtë? Në bazë të Rregullores aktuale 12 javë janë të garantuara për një lehonë me kompensim material, kjo jo vetëm që është diskriminuese për nënën dhe fëmijët, por d.m.th. dhe mirëqenien e fëmijës, kundërshtim me strategjinë e shëndetësisë për fillimin e shëndetshëm të jetës, në kundërshtim me parimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë që qumështi i gjirit të nënës është ushqim ekskluziv në 6 muajt e parë, zvarritja e implementimit të kontratës kolektive në njërin anë, dhe, edhe pse Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ka pretenduar që këtë gjë ta rregullon përmes Ligjit për sigurime shëndetësore, zvarritja e miratimit në lexim të dytë, për shkak të një ligji tjetër që është Ligji për menaxhimin e financave publike që nuk e ka paraparë themelimin e fondit, kërkoj...

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Kërkoni ta prisni përgjigjen nga Kryeministri apo Zëvendës kryeministri sot në qoftë se doni? Urdhëroni z. Zëvendëskryeministër

ZËVENDËS KRYEMINISTËRI LUTFI HAZIRI –Ju faleminderit! Të nderuar kryetar, të nderuar deputete, deputetë të Kuvendit – Pushimi i lehonisë është një e drejtë që ju garantohet me Ligjin në fuqi dhe me Kontratën Kolektive. Neni 23 i Kontratës Kolektive definon qartë se në çfarë kushtesh mund të fitohet kjo e drejtë. Për pushim të lehonisë kanë të drejtë të gjitha femrat e punësuar gjatë kohës së shtatzënisë dhe të lindjes në kohëzgjatje prej 6 muajsh pa ndërprerë. Pushimi i lehonisë njihet si periudhë kohore pune. Tre muajt e parë të pushimit të lehonisë paguhen nga ana e punëdhënësit, por jo më pak se 70% të pagës së të punësuarës, kurse për tre muajt e tjerë vijues pagesa bie në ngarkesë të fondit të Qeverisë së Kosovës për mbrojtjen e maternitetit jo më pak se 70% nga paga e përgjithshme e të punësuarit. Partnerët socialë: BSKP, Qeveria dhe Oda Ekonomike ,në vitin 2004 e kanë nënshkruar Kontratën Kolektive që për shkak të rrethanave të pafavorshme ekonomike dhe financiare nëpër të cilat po kalon Kosova, ende nuk po gjen zbatim. Qeveria e Kosovës me vullnetin e saj edhe pse duke ditur kapacitetet e saj financiare dhe buxhetin e limituar, ka ndërmarrë veprime për zbatimin e kësaj kontrate në bashkëpunim me partnerët socialë. Më 21.6.2005 kanë hartuar një aneks për zbatimin e Kontratës kolektive, në mënyrë që të implementohen së paku ato dispozita që mund të implementohen , në të cilat hyn edhe pushimi i lehonisë. Po ashtu duke u bazuar në përpjekje për të gjetur zgjidhje brenda mundësive ekzistuese për pagesën e pushimit të lehonisë, Qeveria e Kosovës më 14 qershor 2006, merr vendim që pagesa e pushimit të lehonisë të fillojë në mënyrë retroaktive nga 1.1.2006. Ky vendim zbatohet për momentin tek të punësuarit e shërbimit civil të Kosovës, që do ta marrin 70% të pagës minimale të Kosovës së përcaktuar nga Këshilli konsultativ trepalësh.

Në kuadër të kësaj, Ministria e Punës, Mirëqenies Sociale e ka nxjerr Udhëzimin administrativ nr. 06-2006 për rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të pagesës për pushimin e lehonisë në shërbim civil të Kosovës, që rregullon dhe përcakton procedurat për realizimin e pagesës dhe të drejtat për tremujorin e dytë të pushimit të lehonisë për nëpunësit e shërbimit civil në të gjitha organet e punësimit të këtij shërbimi.

Qeveria e Kosovës nuk do të angazhohet për të parë dhe të gjejë mundësi të ndajë mjete për krijimin e fondit për mbrojtjen e maternitetit që më pas t'i përmbushë obligimet , në mënyrë të plotë , ashtu siç është përcaktuar me nenin 23 të Kontratës Kolektive për të gjithë të punësuarit në Kosovë, që kanë të drejtë t'u takojnë pa dallim. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fatmire Kollçaku ka pyetje plotësuese – Urdhëroni

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU – z. Zëvendës kryeministër unë konkretisht kisha dashur të di ku është duke u implementuar kjo që 6 muaj do të thotë

janë, do të bie me kompensim material, konkretisht a ka, ku edhe kur ka filluar. Unë e di udhëzimet i përmendet, por a ka filluar konkretisht diku të zbatohet kjo.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Përgjigjen do ta merrni në seancën e ardhshme.

Deputeti Gazmend Muhaxheri ka një pyetje Ministrin Gjini

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. Kryetar. Pyetja ime për ministrin Gjini ka të bëjë për fshatin Hade, në realitet për dislokimin e banorëve të fshatit Hade edhe atë për një të tretën e këtij fshati. Pyetja është konkrete: sa pare ka dhënë Qeveria e Kosovës për dislokimin e këtij fshati edhe sa do t'i kushtojë Qeverisë së Kosovës dislokimi i tërësishëm i këtij fshati.? Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit edhe një herë z. kryetar. Unë do t'jua jap shifrat e sakta të asaj çka është shpenzuar dhe kohën kur janë marrë vendimet. Qeveria me vendimin e parë të 14.03.2004, ka vendosur të dislokohe fshatarët e fshatit Hade. Ishte ky rast miratimi i strategjisë së dislokimit të grupit të punës të Qeverisë. Më vonë janë marrë edhe vendimet e Përfaqësuesit Special dhe vendime të tjera të Qeverisë ,që nuk do t'i lexoj tash për shkak të kohës, mirëpo mjetet e ndara të Qeverisë së Kosovës për fshatin Hade deri më tani janë 18 milion e 900.000 € përafësisht do të thotë 18 milion e 900.000 € pak më pak se 19 milion. Pjesa më e madhe janë ndarë në vitin 2005 dhe në vitin 2006,por kanë mbetur pa u shpenzuar edhe 5 milion të parapara prej 9 milionëve që të shpenzohen në këtë vit. Arsyeja pse kanë mbetur pa u shpenzuar është për shkak se duhet të shpenzohen deri në fund të vitit edhe për shkak se duhet të plotësohet dokumentacioni për të gjithë fshatarët, që duhet të kompensohen. Ju e dini se Qeveria e Kosovës nuk mund të kompensojë prona që nuk e kanë dokumentacionin komplet .Do të thotë për të ato që ekziston dyshimi më i vogël se titullar mund të jetë dikush tjetër, do të thotë dokumentacioni duhet të jetë plotësisht i rregullt. Ka pasur edhe ndryshime të kriterëve për kompensim, por nuk ka pasur kriterë të reja, por ndryshim të kriterëve. Ndryshimi i kriterëve ka ndodhur për shkak se në disa raste është paraqitur si fakt se një pronar e ka pasur edhe rrugicën pronë të tij. Prapë është dashur të hyhet në diskutime të ndryshme dhe në verifikim të fakteve, për shkak se e gjithë toka e fshatit Hade në realitet është tokë bujqësore, nuk është tokë ndërtimore. Ky është një fenomen që ndodh në Kosovë nëpër fshatra për shkak se për shumicën e ndërtimeve nuk ka leje ndërtimi.. Do të thotë kjo është ajo çka është shpenzuar deri më tani. Pra,duhet të parashihet që për pjesën tjetër Hade 2, do të nevojiten edhe 24 milion 615.000 €. Sipas këtij vendimi, për shkak se deri më tani është zhvendosur vetëm pjesa e Hadës, ku ka qenë rrezikshmëria më e lartë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër. Z. Muhaxheri e ka edhe një pyetje shtesë .Një minutë.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI - Ju faleminderit z. ministër, d.m.th. në kohën e varfërisë më të madhe që e kemi ne si Kosovë, 18 milion € janë ndarë për ta

zhvendosur një të tretën e një fshati. Po pyes ministrin ose kush di të përgjigjet; – Kush i ka caktuar prioritetet e zhvendosjes së këtij fshati dhe për ç'arsye?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Urdhëroni z. ministër Gjini

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë e përmenda vendimin e parë të Qeverisë-Grupit të punës të Qeverisë që është marrë në vitin.2004. Kriteret për zhvendosje, do të thotë kriteret e kompensimit janë caktuar atëherë në bazë të vlerës së tregut të pronës, sa paguhej shtëpia, sa paguhej toka bujqësore, sa paguheshin edhe drunjtë e mbjellë nëpër oborre, sa paguhej rrethimi i oborrit edhe të gjitha të tjerat. Këto kritere mund t'jua sjell herën tjetër, për shkak se nuk kam pasur pyetje që ku kërkohen kritere, mirëpo do t'ju them se përafërsisht është 400 € një metër e shtëpisë së banimit me kualitet të lartë, kategorizohet me kualitete dhe janë vlerë e tregut. Ndërsa, pse është marrë vendimi për shkak se ajo pjesë duhet të eksproprijohet në të ardhmen, sepse shtrihet në fushën e thëngjillit, mirëpo pjesa e rrezikshmërisë së lartë është dashur të kompensohet shpejt për shkak se ka ekzistua rrezikshmëri e lartë për shembje të dheut. Nëse dikush e konteston rrezikshmërinë, atëherë unë mund t'ju them vetëm kështu: si institucion kur unë e marrë një vendim të një komisionit të pavarur profesional, në të cilin thuhet se në këtë pjesë ekziston rrezikshmëri e shembjes së dheut, atëherë unë si ministër jam i obliguar të marr masa dhe ta dislokoj atë pjesë, përndryshe Qeveria e Kosovës dhe ju si deputetë do ta merrnit barrën e përgjegjësisë nëse diçka do të kishte ndodhur në atë rast, do të thotë, unë e marr me shkrim vlerësimin e rrezikshmërisë dhe duhet të marr vendim. E kam marrë atë vendim. Pra, kjo është krejt ajo çka ka ndodhur. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit! Deputetja Selviqe Halimi ka pyetje për ministrin Gjini

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit! Çështja ka të bëjë: banorët e fshatit Hade që ende po maltretohen me moszgjidhjen e problemit të tyre. Ndërrohen kriteret e vlerësimit, rivlerësimi bëhet pasi t'u rrenohen shtëpitë, z ministër. Ndryshimi i këtyre kritereve ka pasuar të bënte edhe me nënvlerësimin e pasurisë së tyre. Sa herë u bënë ndryshime te kritereve të vlerësimit të pasurisë së tyre dhe pse?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Urdhëroni z. Ministër

MINISTRI ARDIAN GJINI - Ju faleminderit z. kryetar, i faleminderit deputetes Halimi. Mendoj se pyetja është shtruar me insinuatë të brendshme për shkak se thuhet po maltretohen. Esencialisht është një diskonfort i njerëzve që largohen prej shtëpive të veta, mirëpo pak më përpara e përmenda çmimin me të cilin janë kompensuar. Mendoj se as deputetja Halimi nuk mund ta shesë shtëpinë e vet në atë vlerë që nuk do të rrenohet. Tjetra është: ndryshimi i kritereve, thotë, po pason nënvlerësimin e pronës. Është e kundërta Kurdo të kishte dashur, cilido deputet që do vinte në Ministri dhe të shihte se çka ka ndodhur me ndryshimin e kritereve, do ta kishte parë se ndryshimi i kritereve esencialisht e ka rritur vlerën e kompensimit, pra nuk e ka zvogëluar, do të

thotë është e kundërta. Këtu janë dy insinuata në këtë pyetje, mirëpo sa herë do t'ju them, tri herë ka pasur ndryshim të kriterëve për pronat që kanë dal si rrugica private, ka pasur ndryshim të kriterëve për pronat që kanë dalë si rrethoja të shtëpive dhe janë ankuar fshatarët dhe kanë thënë: i kemi pasur me material të fortë ose me material të butë. Gjithmonë është marrë për bazë ajo që kanë kërkuar fshatarët e Hades .Edhe herën e fundit kemi pasur raste në cilat një stalle i është hapur dera drejtë rrugës dhe është shndërruar në objekt komercial. Edhe në këso rastesh ka pasur ndryshim kriteresh, do të thotë i kemi kompensuar në formën si kanë dashur. Ajo çka dua të shtoj këtu, po ashtu është se, fshatarëve të Hades u është paguar Qiraja gjatë kësaj kohe dhe ende vazhdon t'u paguhet. Atyre u paguhet kompensim nga 50 € për kokë banori për ushqim, do të thotë atë që mund të bënte Qeveria e ka bërë, mirëpo duhet të pajtohemi me ju se nuk është lehtë të zhvendosen fshatarët, sepse ka diskonfor në zhvendosje dhe në shkatërrim të pasurisë, por nëse thuhet se janë dëmtuar dhe nëse thuhet se janë maltretur, unë mendoj se nuk është mirë të përmenden këto fjalë për shkak...

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit z. ministër. Keni pyetje plotësues?

DEPUTETJA SELVIJE HALIMI - Ju faleminderit z. ministër për përgjigjen jokonkrete. Pyetjen e kishit jo të qartë. Sa herë janë ndërruar kriteret e vlerësimit dhe pse? Kriteret e vlerësimit janë ndërruar një herë, janë bërë para se të shemben shtëpitë, pastaj janë ndërruar pasi janë shembur shtëpitë, jo në dobi të qytetarëve, por dy kontratat që i kam unë këtu nuk i kanë nënshkruar banorët e asaj pjese, janë kontrata konkrete, ka nënvlerësim afër 10.000 €. Edhe sikur të ishte ashtu siç thatë ju, atëherë e paskeni shkelur ligjin nëse keni vepruar sikur ata kanë dashur, kurse sa i përket shitjes së shtëpisë sime, unë nuk kam shtëpi, e kam një banesë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. Ministër

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryetar. Sikur të kishte qenë pyetja e deputetes Halimi se a ka pasur raste në të cilat ka pasur ulje të vlerës së pronës, ndoshta përgjigja do të kishte qenë po. Do të isha interesuar të di se a ka raste? Kur flasim për kriteret dhe kur flasim për vlerën e kompensimit total, është rritur pas çdo ndryshimi të kriterëve, edhe nëse nuk të duket ty i saktë numri 3 i tri rasteve të ndryshimeve, atëherë nuk di çka është më konkrete. Më pyetet a ka pasur raste? Ju thash po tri raste. Nuk e di qysh është përgjigja ma konkrete.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Safete Hadergjonaj ka pyetje për ministrin Shatri

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ - Rënia e buxhetit nga viti në vit, trendi i ulët dhe jo transparenca e të hyrave vendore, shfrytëzimi joefektiv dhe i buxhetit dhe moskthimi i tatimeve të paguara në formë të mirash publike po bëhen shqetësim për qytetarët. Nëse vazhdon kështu, siç është duke u zhvilluar situata ,do të hyjmë në kriza edhe më të thella ekonomike. E pyes z. ministër: sa është numri i bizneseve të regjistruara dhe sa prej tyre i kanë paguar obligimet tatimore? Kuptohet edhe sa nuk i kanë paguar?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Z. ministër keni përgjigje? Urdhëroni

MINISTRI HAKI SHATRI – Ju faleminderit! Është pikërisht kjo pyetje që e kam marrë dhe që jam përgatitur të përgjigjem. Duke filluar nga viti 2003 përgjegjësia dhe kompetenca për regjistrimin e bizneseve është bartur nga komuna në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, pra regjistrimi i bizneseve bëhet në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë. Sipas të dhënave nga Ministria e Tregtisë, është gjendja e fundit kur janë marrë të dhënat. Numri i bizneseve të regjistruara është 53.882. Në këtë numër hyjnë bizneset aktive deri në vitin 2004, kur është urdhëruar një regjistrim i bizneseve, për arsye që Ministria i ka konsideruar të domosdoshme, si dhe ato që janë regjistruar rishtas, pas qershorit të vitit 2004. Sipas të dhënave që i kemi në Administratën Tatimore të Kosovës, dosjet e hapura në sistem kanë 52.855 biznese, prej këtyre bizneseve aktive që paguajnë tatim janë 46.483 biznese. Nga ky numër, që paguajnë janë 5098 j tatimpagues të TVSH-së, pra konsiderohen tatimpagues të mëdhenj që kanë qarkullim vjetor mbi 50.000 €. Ndryshimi ndërmjet shifrës së evidencës në sistem dhe atyre që paguajnë, qëndron te bizneset e regjistruara, por që nuk janë aktive. Dua t’jua përkujtoj që në këtë numër, pra në mes të atyre që janë në sistem dhe të atyre që janë të regjistruara, qëndron edhe te fakti se shumë biznese regjistrohen jo për të zhvilluar aktivitetet bisnesor, por për të nxjerrë përfitime të rastit. P.sh.: ka biznes që regjistrohet, nuk i kushton shumë për të përfituar ose për ta nxjerrë një kredi në një moment të caktuar dhe për ta shfrytëzuar atë për qëllime të tjera, jo për qëllime biznesore. Ka mundësi të regjistrohen biznese edhe nga vendet e tjera, ta japin një adresë dhe kurrë të mos e zhvillojnë aktivitetin e tyre në vendin që e kanë paraqitur adresën e rregullt me rastin e regjistrimit. Për të gjitha këto jemi të vetëdijshëm dhe me aktivitetin që është zhvilluar nga mesi i vitit të kaluar në Administratën Tatimore të Kosovës. Në bashkëpunim me njësinë e krimeve ekonomike kemi zhvilluar aktivitete dhe kemi arritur shtrirje në vijë horizontale në përfshirje. Shtrirja është realizuar dhe si rezultat i saj. Vetëm në pesë muajt e parë të këtij viti kemi një rritje të inkasimit 10% më të madhe se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dua t’jua përkujtoj edhe faktin se nuk janë duke rënë të hyrat buxhetore, të hyrat fiskale. Na ju kemi dërguar çdo muaj dhe çdo vit raportet e të hyrave buxhetore dhe raportet për buxhetin për vitin përkatës dhe periodike. Sa për ta informuar opinionin të hyrat buxhetore janë rritur nga viti 2001 kur kanë qenë 304 milion, në vitin 2002 499 milion, në vitin, në vitin 2003 589 milion, në vitin 2004 611 milion, në vitin 2005 628 milion dhe në vitin 2006 janë të parapara 641 milion, por presim që kjo shifër të tejkalohet. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Jemi të vetëdijshëm se e kemi tejkaluar kohën prej 50 minutash. Ne e kemi vetëm edhe një pyetje, nëse pajtoheni që ta përfundojmë. Mirë, urdhëroni një pyetje plotësuese

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Mirë që ministri deshi të thoshte diçka, por faktikisht nuk tha asgjë në lidhje me pyetjen, që unë ia kam parashtrua. Edhe më vjen mirë që për këtë u përgjigj, se meqë nuk ishte i gatshëm të përgjigjej në pyetjen e parë, me qenë se ligji obligon të dimë e të kesh të dhëna. Unë do të bëja pyetje: a ka ndjekje penale për kundërvajtje, nëse ka a mund të na i thuani emrat e personave që janë

të dënuar dhe shumën e tatuar të përfshirë si dhe a janë të njëjtat dënime për mos pagesë për të gjithë tatimpaguesit?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ministër respektone kohën ju lutem

MINISTRI HAKI SHATRI – Obligimet tatimore janë të parapara me ligji përkatës. Të gjithë ata që pas procedurave të parapara me ligj nuk u përgjigjen kërkesave të tyre, pasojnë masat adekuate që i merr Administrata Tatimore e Kosovës. Ministri i Financave nuk mban emra të njerëzve që janë paditur. Janë evidencat në institucione dhe në organet përkatëse që mund të verifikohen kurdo që dikush dëshiron. Dua t’jua them edhe këtë që ministri i Financave nuk ka faj që dikush nuk i lexon raportet periodike që ia dërgojmë Kuvendit çdo muaj, çdo tremujor dhe në fund të çdo viti. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit! Pyetja e fundit është e deputetet Teuta Sahatqija për ministrin Dugolli

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIU – Ju faleminderit z. kryetar. I nderuari ministër i Tregtisë, z. Dugolli. Pyetja ime është: Pse nuk zbatohet vendimi i marrë nga gjykatat për regjistrimin e shoqatave aksionare të Gjakovës?. Ndërmarrjet aksionare të Gjakovës kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre për padi dhe kanë paditur Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, sepse janë të privuar nga e drejta e tyre për regjistrimin e biznesit. Gjykata Ekonomike më 21.9.2005 mori aktgjykim me të cilin obligohet Ministria që në afat prej 10 ditësh pune të bëjë regjistrimin e bizneseve. Gjykata Supreme, si instancë më e lartë më 14.12. 2005 e vërteton aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut të Prishtinës dhe e hodhi poshtë ankesën e Ministrisë, me ç’rast e obligon Ministrinë që në afat prej 10 ditësh ta bëjë regjistrimin e bizneseve

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit ! Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Ju faleminderit z. kryetar, deputetë, ju falënderoj për mundësinë që na keni dhënë si ministra t’u përgjigjemi pyetjeve të deputetëve. E falënderoj deputeten Sahatqija për pyetjen. Siç dini, kjo çështje është bukur preokupuese dhe ka përcjellë institucionet e Kosovës nga themelimi. Çështja përafërsisht ka të bëjë me 49 ndërmarrje të Gjakovës që pretendojnë se janë bërë transformimet në bazë të ligjeve të ish- Federatës Jugosllave,(Gazeta zyrtare 77, 88.) Ligjin për ndërmarrjet, d. th. th. Ligji për letrat me vlerë, po ashtu i kësaj federate(64/89 dhe 20/90) dhe Ligjin për transformimin e kapitalit shoqëror,(Gazeta zyrtare RSFJ 34/99 dhe 60/99), pra pretendimet janë që në bazë të këtyre ligjeve janë bërë transformimet, ndërsa legjislacioni në fuqi në Kosovë është Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 për ndryshimet si dhe plotësimin Rregullorja 2005/18 që e thotë, që të gjitha ndërmarrjet shoqërore dhe ndërmarrjet publike janë në kompetencë të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, konkretisht nenet 5 dhe 6 të Rregullores se caktuar, pra Agjencioni i regjistrimit të biznesit, Ministria e Tregtisë e Industrisë nuk mund dhe nuk ka bazë

ligjore të bëjë ndryshimin e statusit të ndërmarrjeve nga ndërmarrjet shoqërore në shoqëri aksionare. Thjeshtë kjo është çështje e rezervuar dhe i mbetet në kompetencë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Ne këtë çështje e kemi ngritur edhe te qeveria e re, të bordi i ri i AKM-së dhe e kemi diskutuar disa herë në mbledhje të radhës të gjithë Bordit. Kemi mbajtur disa takime me pronarët e kompanive dhe me Këshillin ekzekutiv të komunës së Gjakovës dhe kemi ardhur në përfundimi të mos e tolerojmë statuskuon me këto ndërmarrje. Do të fillojmë privatizimin dhe do të shikojmë në bazë të auditimeve që do të bëhen nga njësitë profesionale të AKM-së për ta vërtetuar se a ka pasur transformim dhe në çfarë përqindjeje ka pasur transformim. Si rezultat i saj, ne i kemi privatizuar ndërmarrjen "Mulliri", ndërmarrjen "Model", ndërmarrjen "Mishi", fabrikën e materialit ndërtimor dhe "Erenikun" fermën e shpendëve dhe janë në procedurë të privatizimit edhe disa ndërmarrje. Në ndërkohë gjykatat e caktuara kanë bërë padi në gjykatën që u përmend dhe kanë ardhur disa vendime për ndërmarrjen "Industria", për ndërmarrjen "Tregtia", për ndërmarrjen "Ereniku", që kërkojnë regjistrimin. Ne në konsultim me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, me dakordimin e tyre e kemi bërë një formë të regjistrimit, por ka shumë dhe kemi ndërhyrë në softverin e Ministrisë që ndërhyrja të kushtojë disa mijëra euro që janë siguruar nga AER-i për këtë çështje dhe sot ka përfunduar regjistrimi i tyre në një rubrikë të veçantë si bizneset e tjera, që nënkupton se janë nën autoritetin e AKM-së. Pas shqyrtimeve të auditorëve profesionalë do të vërtetohet se sa ka pasur transformim dhe në çfarë baze dhe është vendim i Bordit që ta heqë nga regjistri apo ta lë në regjistër, që do të thotë se ne jemi të obliguar dhe do t'i respektojmë vendimet e gjykatave, por nuk mund ta ndryshojmë statusin e ndërmarrjes. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

Keni pyetje plotësuese? Po. Urdhëroni.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. ministër për gatishmërinë tuaj për t'ju përgjigjur pyetjeve parlamentare.

Sot në fillim të seancës e dëgjuam z. Petersen ,që edhe një herë e ceku sundimin e ligjit, për të cilin secili qytetar dhe secili institucion duhet ta ketë parasysh dhe të punojë.

Pra, dihet se sundimi i ligjit është standard që do të na çojë në procesin e pëercaktimit të statusit. Gjithashtu është një standard jashtëzakonisht i rëndësishëm për të krijuar Kosovën shtet juridik e funksional mendoj që të gjitha institucionet tona duhet ta kenë parasysh dhe ta respektojnë sundimin e ligjit.

Pyetja ime është: Në qoftë se një gjykatë merr vendim, apo në qoftë se ekziston ligji, pyes a është kompetencë e Ministrisë , e Qeverisë apo APK-së të punojë.?

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëro z. ministër.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – Ju e dini se konform ligjit është formuar në kuadër të Gjykatës Supreme një dhomë e posaçme që merret me shqyrtimin dhe me rastet që janë pjesë të rezervuara, që kanë të bëjnë me AKM-ën. Gjatë bisedës me kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës kam thënë vendimet e gjykatave kosovare të mos jenë

në kundërshtim me regjistrimin sipas ligjit. Sipas kësaj që u tha, ne nuk e pengojmë regjistrimin, por për ta ditur si ta regjistrojmë ne do t'i kem faktet dhe këto duhet t'i trajtojë ekipi i posaçëm kompetent për këtë çështje. Pasi t'i trajtojë këto fakte ne do të veprojmë konform shkresës përcjellëse që do të vijë nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Deri në atë kohë ne do t'i regjistrojmë bizneset me një rubrikë të veçantë që e kemi themeluar enkas për këtë çështje, por ju lutem ne duhet të punojmë me një sistem nuk duhet të punojmë për dike ndryshe për dike ndryshe, prandaj duhet ta dimë që çështjet e transformimeve se si ka ndodhë dhe se pranojmë për dikon duhet të pranojmë edhe për të tjerët, prandaj duhet t'i argumentojmë me fakte të forta se çfarë transformimi ka pas dhe mos ta pengojmë procesin e privatizimit. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit.

Me kaq përfundon periudha e pyetjeve, kemi pauzë prej 1 ore, në ora 3 vazhdojmë me seancë.

VAZHDON SEANCA PAS PAUZE

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ftoj deputetët që nuk janë të sallë të kthehen sa më shpejtë ju lutem.

Vazhdojmë më punë të mëtutjeshëm.

Sa për njoftim, në sallë janë të pranishëm 65 deputetë që do të thotë mund të punojmë.

Pika e katërt e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peshkatarinë dhe akuakulturë

Projektligji është shpërndarë deputetëve më 30 maj 2006 dhe janë përmbushur të gjitha kushtet për shqyrtimin e tij dhe aprovimin në parim.

Vërejtjet parimore do të adresohen për shqyrtim Komisionit funksional përgjegjës për raportim si dhe komisioneve kryesore.

Ftohet sponsori i Projektligjit zëvendësministri Tomë Hajdaraj ta marrë fjalën.

ZËVENDËSMINISTRI TOMË HAJDARAJ – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Shkurtimisht po e paraqes Projektligjin për peshkatarinë dhe akuakulturë, duke cekur nevojën e nxjerrjes së tij.

Fauna e ujërave është pasuri me interes të përgjithshëm që duhet të menaxhohet drejt me qëllim të ruhet biodiversiteti për të sotmen dhe për të ardhmen. Për të siguruar këtë është e nevojshme të krijohet infrastruktura e nevojshme ligjore për menaxhim të

qëndrueshëm të burimeve peshkore dhe për krijimin e kushteve të zhvillimit të akuakulturës me qëllim të plotësimit të nevojave të tregut.

Qëllimet kryesore të nxjerrjes së këtij ligji

Propozimi për nxjerrjen e këtij ligji bëhet me qëllim të krijimit të kornizës ligjore, me të cilën rregullohet menaxhimi i resurse peshkore dhe tërë veprimtaria e peshkatarisë dhe e akuakulturës që zhvillohen në ujërat e territorit të Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është shfrytëzimi racional i faunës së ujërave dhe ruajtja e biodiversitetit, përcaktimi i masave mbrojtëse, menaxhimi i resurseve peshkore, përcaktimi i mjeteve dhe i pajisjeve që mund të përdoren për peshkim etj.

Projektligji ka një strukturë komplete dhe përmbajtjesore, e cila përbëhet prej IX kapitujsh dhe është hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore e në harmoni me standardet e BE-së.

Në kapitullin I të këtij projektligji, me dispozitat e përgjithshme rregullohen: lënda, qëllimi, përkufizimet e nocioneve që përdoren në këtë ligj, si dhe ndarja e ujërave të peshkimit.

Kapitulli II përmban dispozitat që rregullojnë ujërat e peshkimit në tërë territorin e Kosovës, ndarjen e territoreve të ujërave të peshkimit në rajone apo zona peshkimi, format e shfrytëzimit për peshkim, të drejtën e menaxhimit, kohëzgjatjen e së drejtës së shfrytëzimit, si dhe programet e menaxhimit.

Kapitulli III rregullon peshkimin, mjetet dhe pajisjet e peshkimit, lejet për peshkim, peshkimin ekonomik, peshkimin rekreativ – sportiv, provimin për peshkim dhe Federatën e Peshkatarëve të Kosovës. Pra, anëtarësimi në këtë Federatë është në baza vullnetare.

Kapitulli IV përmban dispozita që rregullojnë akuakulturën dhe aktivitetin që mund të zhvillojnë personat fizikë dhe juridikë që janë të regjistruar dhe licencuar për akuakulturë, si dhe shfrytëzuesit e resurseve ujore.

Kapitulli V përmban dispozita që rregullojnë mbrojtjen e peshkimit si dhe peshkimin për qëllime të veçanta si; peshkimi për qëllime hulumtuese – shkencore, peshkëzimin e rajoneve ose të zonës së marrë për shfrytëzim sipas planit vjetor të menaxhimit, mbrojtjen shëndetësore të fondit të peshqve, rojet e peshkimit si dhe ndalimet e peshkimit.

Kapitulli VI i këtij projektligji rregullon tregtimin e peshqve që mund të bëjnë prodhuesit, ndërmarrjet, personat fizikë dhe juridikë, si dhe kushtet për tregtimin e peshqve.

Kapitulli VII përmban dispozita për mbikëqyrjen dhe inspektimin e zbatimit të këtij ligji, në të cilat parashihet të bëhen inspektorë duke përcaktuar autorizimet dhe detyrat e tyre për mbikëqyrje dhe kontrollim, si dhe masat që mund të ndërmerren nga inspektori dhe procedurat e inspektimit dhe kontrollimit.

Kapitulli VIII përmban dispozitat ndëshkimore .

Kapitulli i IX përmban dispozitat kalimtare dhe fundit .

Ky projektligj është hartuar nga ekspertët e Ministrisë përkatëse. Në fazat e shqyrtimit të këtij projektligji janë bërë hulumtime dhe konsultime të gjera në këtë fushë. Është shqyrtuar legjisllacioni i shteteve të BE-së, si dhe shteteve tjera të rajonit. Të gjitha vërejtjet e dhëna janë futur në Projektligj. Nga shtetet e rajonit janë shfrytëzuar :Ligji për peshkatarin dhe akuakulturë i Sllovenisë, i Shqipërisë, i Kroacisë dhe i Bosnje-Hercegovinës. Gjatë hartimit të projektligji janë marr parasysh edhe specifikat e Kosovës.

Sipas shpjegimeve të dhëna lidhur me Projektligjin për peshkatarin dhe akuakulturë propozojmë që ky projektligj të miratohet nga Kuvendi i Kosovës.
Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. zëvendësministër. Fjalën e ka deputeti Shaban Halimi, sigurisht në emër të Grupit të deputetëve të LDK-së, urdhëroni.

DEPUTETI SHABAN HALIMI - Faleminderit z. kryetar, i nderuari z. zëvendësministër, të nderuar kolegë deputetë.

Ne anëtarët e Komisionit për Bujqësi, Pylltari e Zhvillim Rural të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike kemi pasur në shqyrtim këtë projektligj dhe kemi ardhur në përfundim që t'i prezantohet edhe Grupit Parlamentar të LDK-së ,prej të cilit kemi marrë pëlqimin që ky p/ligj në leximin e parë të kalojë me qëllim që t'i hapet rruga në lexim të dytë ,në realitet komisioneve për ta bërë punën e tyre ose për ta amendamentuar ligjin.

Arsyet që na kanë detyruar që ky ligj të kalohet janë për shkak se kjo fushë veprimtari është rregulluar me ligjet e mëparshme që do të thotë me ligjin 234/1 të vitit 75, që bazohet në ekonominë e planifikuar dhe në pronën shoqërore,por që për momentet në ekonominë e tregut dhe në pronën private nuk mund të ketë zbatim.

Gjithashtu me këtë ligj do të thotë vihet korniza ligjore e kësaj fushë të veprimtarisë , ku pastaj me akte nënligjore dhe me ligjet e tjera terciale, në të vërtetë sekondare, që do t'i nxjerrin Komisioni dhe grupet e tjera,do të plotësohet edhe më tepër ky ligj dhe do të gjejë funksionalitetin e vet, Prandaj Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike jep votën e vet pro leximit të parë të këtij Projektligji. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

DEPUTETI BERAT LUZHA – I nderuar z. kryetar, të nderuar deputetë.

Projektligji për peshkatarinë dhe akuakulturën është hartuar në dhjetor të vitit të kaluar, kurse i është dërguar në Kuvend për procedurë në fund të majit 2006. Do ta kisha pyetur zëvendësministrin se cili është shkaku i një vonese kaq të madhe rreth 5 muajve që nga hartimi deri te dërgimi në Kuvend.

Ky ligj është i kompiluar dhe i adaptuar sipas ligjeve të disa vendeve të rajonit, por nuk është harmonizuar në standardet evropiane. Nuk e rregullon çështjen e higjienës së ushqimit për prodhimet e peshkut, për këtë mungesë ka reaguar edhe Zyra e Proceseve për Integritet Evropiane.

Ligji nuk mbron pastërtinë e ujërave, sidomos të lumenjve tanë ku derdhen ujërat e zeza e mbeturinat, por edhe lëndët helmuese që bënë të pamundur jetën e peshqve në to. Përmendet kodi i peshkimit, për të cilën ne nuk jemi në dijeni që ekziston. Propozoj që ligji të quhet Ligji për peshkatarinë dhe kulturë të ujërave dhe jo akuakulturë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim miratimin e këtij projektligji, por me kusht që të përmirësohet dhe të standardizohet. Faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj në emër të AAK-ës.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. zëvendësministër dhe deputetë.

Ligji aktual i peshkatarisë, i nxjerrë në vitin 1975, nuk mund të aplikohet, sepse ka pasur në bazë ekonominë e planifikuar dhe pronën, që është tejkaluar. Tani kemi një legjislacion të ri, një ekonomi tjetër të tregut dhe kështu edhe ligjet e tjera duhet të ndryshohen.

Prandaj me ligjin që sot gjendet në Parlament do të rregullohen më mirë menaxhimi i peshkatarisë dhe i akuakulturës që ushtrohet në ujërat e territorit të Kosovës.

Me këtë ligj do të ruhet fauna e ujërave. Kjo pasuri është në interes të përgjithshëm me qëllim të ruajtjes së biodiversitetit. Edhe unë pajtohem me z. Luzha në lidhje me titullin e këtij ligji dhe e përkrahim edhe Grupin Parlamentar të AAK-ës dhe të LDK-ës, në përbërjen e së cilës ka deputetë të AAK-së dhe të LDK-së. E përkrahim që në leximin e parë të votohet ky ligj. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Teuta Sahatqija në emër të ORA-s

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. kryetar. Edhe Grupi ynë parlamentarë e ka pasur ligjin dhe e ka analizuar në mbledhjet e grupit. Për këtë ligj mjaft gjëra i thanë parafolësit. Prandaj nuk do t'i kisha përsëritur. Mendoj që për këtë ligj duhet të ketë parasysh dhe të precizohen aktet nënligjore dhe koha kur do të bihen këto akte nënligjore që do ta precizojnë më tepër këtë ligj.

Sa i përket amendamentimit ne kontributin tonë do ta japim në Komision, ashtu që ligji të jetë sa më i përshtatshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Rifat Krasniq në emër të Grupit 6+.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ – Faleminderit z. kryetar.

Sayın Başkan, Sayın Bakan yardımcısı, Değerli Milletvekilleri

Tarımcılık, Ormancılık ve Kırsal Alan Geliştirilmesi Komisyonu adına, Tarım Bakanlığı tarafından hazırlanmış olan bir Yasa Tasarısını daha selamlayarak, diğerlerinin olduğu gibi bu Yasanın da, Kosovadaki yaşamının önemli boşluklarını doldurduğunu belirtmek istiyorum. Balıkçılık ile Akuakültür Yasası ileride, şu anda Kosova yöresindeki sularda hiçbir denetim yapılmadan, balıkçılık ile akuakültür alanında etkinliklerin yönetilmesini düzenleyecektir. Oldukça ağır ekonomi durumunda olan Kosova halkı, balıkçılık sayesinde hem bulunduğu durumdan kurtulmaya, hem de kendi ailelerinin geçimini sağlamaya çabalanmaktadır.

Bundan ötürü de ben bir kez daha Tarım Bakanlığının bu çalışmasını selamlıyor, sözkonusu Yasa Tasarısının onaylanması amacıyla, tüm ilgililere Komisyonumuzun ilerideki toplantılarından birinde katkı sunmaları çağrısında bulunuyorum.

İlginize teşekkürler!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Me qenë se nuk ka deputetë të tjerë të interesuar të diskutojnë rreth këtij ligji, lus deputetët dhe regjinë të përgatitemi për miratim në parim. Urdhëroni z. Nekibe.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Edhe unë angazhohem për atë që titulli të shqiptohet akuakulturë, sepse ka të bëjë ne kulturën e ujërave ose me kulturë ujqor Gjuhëtarët tanë e dinë më mirë, por kryesorja të shqipërohet, se ky ligj shkruhet edhe për shtresën e gjerë dhe jo vetëm për institucionet.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Mirë, përgatitemi të votojmë në parim për ligjin me vërejtjet që e dhanë për titullin e ligjit.

Sa për njoftim në sallë 71 deputetë

Votojmë tash:

Për63;
Kundër..... 1.

Do me thanë ligji kalon.

Komisioni në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë duhet të shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet dhe rekomandimet , sipas rregullës 35.6.

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për prokurimin publik në Kosovë

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 8 qershor 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim .

Ftoj deputetin Naser Osmanin ta marrë fjalën.

DEPUTETI NASER OSMANI – Faleminderit z. kryetar. Unë qysh në fillim të seancës kam parashtruar kërkesën në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa që projektligji në fjalë të mos debatohet sot ,por të jepet mundësi që Qeveria ta përcjellë në Kuvend në një procedurë tjetër. Unë do të detyrohem që edhe një herë ta lexojë shkresën e përpiluar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Në bazë të kreut IX paragrafi 9.1.35 i Komizës Kushtetuese dhe Rregullores 36 dhe Rregullores së përkohshme për punën e Kuvendit të Kosovës Komisioni për Buxhet në mbledhjen e mbajtur më 28.6.2006 shqyrtoi këtë projektligj për prokurimin p ublik dhe nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni shqyrtoi Projektligjin për prokurim publik dhe i rekomandon Kuvendit ta heqë nga rendi i ditës dhe t'ia kthejë Qeverisë me kërkesë që sa më parë ta sjellë Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit ekzistues për prokurimin publik nr. 2003/17. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Faleminderit. Urdhëro.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI LUTFI HAZIRI – Faleminderit z. kryetar, deputetë të nderuar ,zonja dhe zotërinj .i nderuari z. Osmani.

Më lejoni që t'i paraqes arsyet për ndryshim dhe në parim pajtohem me Ligji për prokurim publik sipas kërkesës së Komisionit mund të kthehet dhe mund të bëhen ndryshimet nëpërmjet amendamentimit dhe të kalojë në procedurë. Qeveria e Kosovës me këtë kërkesë të institucioneve buxhetore dhe të agjencive ndërkombëtare që mbështesin institucionet tona ,në veçanti të Agjencisë Evropiane të Ndërtimit ka kërkuar

ndryshimin e Ligjit për prokurim ,që do të duhej të standardizohej me kërkesat e Bashkësisë Evropiane dhe tanimë nuk ekzistojnë as arsyet për të cilët ne i kemi filluar dhe i kemi bërë projektet dhe Qeveria e ka miratuar, nëse Kuvendi dhe grupet parlamentare besojnë që nëpërmjet ndryshimeve mundin të inicohen, ne pajtohemi. Ju faleminderit !

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Gani Koci.

DEPUTETI GANI KOCI – Faleminderit z. kryetar. Unë mendimin edhe në emër të Grupit Parlamentar, por edhe si anëtar i Komisionit e dhashë që në fillim kur u shtrua kjo çështje. Nuk dua të ndalem rreth historikut të idesë së ndryshimit të këtij projektligji se është e vërtetë që kërkesat së pari kanë ardhur nga ata që ishin në fillim edhe propozues edhe financues të këtij projektligji, pikërisht nga AER-i dhe ideja e parë ka ardhur nga AKM-ja. Ajo ka kërkuar ndryshimin e Projektligjit jo nëpërmjet institucioneve qeveritare, por nëpërmjet AER-it edhe pikërisht për faktin tashmë të njohur se kjo ka qenë në vitin e kaluar rreth tregtimit ose rreth importimit të energjisë elektrike dhe ajo ka kërkuar edhe procedura të tjera në kundërshtim me ligjin ekzistues që është, por si ide e ndryshimit dhe e plotësimit të ligjit ka ardhur më vonë. Pastaj edhe nga subjektet qeveritare që kanë të bëjnë me këtë ligj , me të cilat edhe si Komision të analizave të shqyrtime të ndryshme dhe në kontaktet që kemi pasur me subjekte të ndryshme, kemi ardhur në përfundim se do të duhej të bëhen ndryshime në disa pjesë të ligjit ekzistues dhe jemi pajtuar që të na vijnë në formë amendamentesh për plotësimin e ligjit.

AER-i ka përgatitur këtë projektligj tash që e kemi në dorë dhe e ka dërguar në Qeveri vitin e kaluar. Qeveria për t'u ikur procedurave të veta, ka kërkuar të shtrohet menjëherë në Kuvend. Formalisht ka krijuar ekip të punës për këtë projektligj ,por që s'ka punuar asnjë ditë në Projektligj dhe si tillë na është servuar neve në fillim të këtij muaji.

Në muajin mars kemi pasur një takim me përfaqësues edhe të AER-itë, edhe me përfaqësues të USAID-it dhe jemi pajtuar çka të ndryshohet. Jemi të bindur se ndryshimet që i pëson Projektligj nuk janë të asaj natyre që ne jemi pajtuar kaherë dhe që është më e keqja e kësaj, diku me përjashtim të atyre ato që i thashë në fillim rreth përjashtimit nga ky ligj të disa subjekteve dhe krijimit të një organi për ankesa që deri tash ka funksionuar në kuadër të organit rregullator, asnjë ndryshim tjetër esencial nuk është bërë në këtë projektligj fare, asnjë ndryshim tjetër esencial . Duke u nisur nga kjo edhe ne si Komision, por edhe si grup parlamentar, mendojmë se ndryshimet që duhet të bëhen në ligjin ekzistues të na vijnë në formë amendamentesh, sepse nuk kemi nevojë ne të nxjerrim ligj të ri kur ekziston ligji tjetër dhe janë disa praktika parlamentare kur del një ligj nga përdorimi, kur një pjesë shumë e madhe e tij pëson shumë ndryshime esenciale.,nëpërmjet amendamenteve. Ne asnjëherë nuk e kemi amendamentuar këtë projektligj.

Prandaj për ndryshimet që duhet të bëhen, ato mund të bëhen edhe në formë amendamentesh dhe si të tilla ne do t'i shqyrtojmë si Kuvend, mund t'i pranojmë ose të mos i pranojmë. Ndryshimet që kanë kërkuar për mendimin tim tash janë krejtësisht të

papranueshme, në qoftë se në ndërmarrje siç thuhet në këtë projektligj në nenin 3.5 ,që ofrojnë shërbime publike ,nuk zbatojnë këtë projektligj ose ligjin e ardhshëm. Për mendimin tim ky ndryshim do të duhej të ishte krejtësisht i papranueshëm, në qoftë se na vjen si ndryshim .

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryetar, z. zëvendëskryeministër, të nderuar kolegë deputetë.

Mbetet pak të them pas këtyre që thanë Naseri edhe Ganiu, sepse edhe më parë kur diskutuam për rendin e ditës kjo pikë e rendit të ditës u shqyrtua dhe në një farë mënyre u dhanë vërejtjet që i patëm të gjithë.

Mendoj se si Kuvend duhet ta shprehim një brengë ndoshta minimale për mënyrën si po tejkalohen projektligjet që po i miratojmë vetë. Në qoftë se ky Kuvend,pavarësisht , ndoshta jo kjo përbërje e Kuvendit, por ky Kuvend e ka miratuar një ligj që është në fuqi aktualisht dhe me të cilën të gjitha organizatat buxhetore të Kosovës funksionojnë dhe i bëjnë prokurimet e tyre . Ky ligj në punë e sipër u vërejt se ka mangësi. Puna e parë që do të duhej të bëhej është që këto mangësi të këtij ligji të përmirësohen që ato defekte që janë vërejtur gjatë punës, nuk ka ligj të përkryer. Çdo ligj në letër duket i përkryer, por kur fillon zbatimi , atëherë shihen mangësitë, pra do të duhej që nenet e papërputhshme me praktikën të ndryshohen dhe të shihen ku bëhen përmirësimet dhe këto përmirësime të ndërmerren pastaj në të njëjtën mënyrë siç edhe është miratuar ligji.

Hedhja poshtë e ligjit të cilën e ka miratuar ky Kuvend në këtë mënyrë, mua po më tingëllon pak sa keq, po më tingëllon pak sa s’di sikur dikush po dëshiron që t’ia lerë fajin ligjit për dështimet eventuale që kanë pasur ndërmarrjet ose AKM-ja si menaxhuese e ndërmarrjeve publike, gjatë procedurave të përpunimit,Nuk them për institucionet e Kosovës ,sepse në to ato auditorët kanë konstatuar defektet shumë kund që ndoshta janë edhe të arsyeshme ,sepse ligji si ligj është në një farë mënyrë në aspektin formal u jetësua shumë vonë, në muajin shkurt të këtij viti. Sapo është formuar Agjencia e Prokurimitin Publik pra, është një organ që derivohet nga ky ligj dhe që është dashur të bëhej shumë më shpejt ,tek në muajin shkurt të këtij viti ja kemi dal të bëjmë APP-ën . APP-është thuajase është organi që rregullon prokurimin në nivel të Kosovës që i shkurton afatet edhe atëherë kur e konsideron se një tender ka nevojë për afat më të përshpejtuar, e jep lejen për ta përshpejtuar afatin e realizimit, kurse ne me një vonesë më tepër se një vjet e kemi themeluar APP-ën. Pra, tash 4 muaj pasi që është themeluar APP-ja ne dëshirojmë ta shfuqizojmë ligjin dhe ta miratojmë një ligj krejtësisht të ri, disi po më duket se po ja lëmë fajin ligjin, ndërkohë që ligji mund të ketë pas defektet e veta por duhet ta bimë këtu ndryshimin e propozuar, ndryshimin e kërkuar ta krahasojmë me variantin të cilën e kemi miratuar një herë në Kuvend dhe të shohim sa e përmirëson ose sa e dobëson ligjin varianti i ri i propozuar.

Prandaj edhe një herë po e përforcojë atë që thanë Naseri dhe Ganiu do të duhej të vinte këtu një Projektligj për ndryshimin e ligjit në të cilën do të vëreheshin saktë të cilat amendamente janë ato të cilat duhet të ndërrohen dhe cilat amendamente është e nevojshme që të përmirësohen. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – faleminderit z. kryetar, i nderuari z. kryetar, z. zëvendëskryeministër, z. ministër, deputetë të nderuar.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështetë propozimin e Komisionit dhe janë së paku dy arsye.

Ligjin ekzistues që e kemi dhe pastaj, ligjin e ri që është sjellë nuk është e qartë se cilat ndryshime dhe plotësime janë bërë dhe ne do të zhvillojmë një praktikë korrekte. Prandaj e mbështesim si Grup Parlamentar rekomandimin e Komisionit, me gjithë se i kuptojmë vështirësitë të cilët me siguri i ka Qeveria në zbatimin e Ligjit. Prandaj t'i kthejmë Qeverisë dhe t'i sjell Qeveria ndryshimet dhe plotësimet e këtij Projektligji. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Xhezar Murati

DEPUTETI XHEZAIR MURATI - Poštovani predsedniče, zemenika prejimera, ministri, kolege poslanici.

Parlamentarna grupa 6+ podržava predlog Komisije za budžet da se ovaj zakon odloži, da oradi, prema tome, dakle mi podržavamo, kolege koje su do sada shvatili potrebu odlaganja, ovaj usvajanja ovog zakona. Hvala!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Konsideroj se propozimi i Komisionit të mos miratohet .U përkrah po thuaj se nga të gjithë diskutuesit e tjerë, atëherë votojmë që të mos miratohet në parim.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatitemi për votim.

Natyrisht që plotësohet me ndryshime dhe bëhen nëpërmjet amendamenteve.

Votojmë tash:

Për..... 44;

Kundër.....13.

Nuk miratohet ky ligj.

Natyrisht që ligji i kthehet Qeverisë. Vazhdojmë më tutje.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik

Miratimi në parim i këtij projektligji është bërë më 23. 2. 2006 . Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raport dhe rekomandime me amendamente.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik ka amendamente të propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për botimin e teksteve shkollore, të mjeteve mësimore, të lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik dhe amendamentet e propozuara. nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Prandaj kalojmë në miratimin e amendamenteve të paraqitura sipas Komisionit funksional.

Amendamenti 1

Votojmë tash:

Për..... 66;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Për..... 69;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për..... 62;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Për..... 69;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Për..... 63;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Për..... 60;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Për..... 59;

Kundër..... 2.

Kalon amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Për..... 62;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Për..... 66;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Për..... 64;

Kundër..... 2.
Kalon amendamenti 10.

Amendamenti 11
Votojmë tash:

Për..... 65;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti 11.

Amendamenti 12
Votojmë tash:

Për..... 65;
Asnjë kundër.
Kalon amendamenti 12.

Amendamenti 13
Votojmë tash:

Për..... 66;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti 13.

Amendamenti 14
Votojmë tash:

Për..... 61;
Kundër..... 3.
Kalon amendamenti 14.

Mungon votimi për amendamentin 15

Amendamenti 16
Votojmë tash:

Për..... 61;
Asnjë kundër.
Kalon amendamenti 16.

Amendamenti 17
Votojmë tash:

Për..... 63;
Kundër..... 1.
Kalon amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Për..... 64;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Për..... 64;

Asnjë kundër.

Kalon amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Për..... 64;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 20.

Amendamenti 21 dhe i fundit.

Votojmë tash:

Në momentin kur po votojmë në sall i kemi 72 deputetë dhe me

Për..... 67;

Kundër..... 1.

Kalon amendamenti 21.

Kalojmë në miratimin e amendamentit në tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Votojmë tash:

Për..... 66;

Asnjë kundër.

Kuvendi i miraton në lexim të dytë Projektligjin me amendamentet që janë parashtruar.
Vazhdojmë me pikën shtatë të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i raportit lidhur me vërejtjet e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut në Ligjin për të drejtat e autorit dhe për të drejtat e përafërta nr. 2004/45 miratuar më 27.9.2004

Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta nr. 2004/45 është miratuar në seancën plenare të mbajtur më 27. shtator 2004 dhe i është dërguar për shpallje PSSP-ës më 21 tetor 2004.

PSSP-ja nëpërmjet Zyrës Ligjore i është drejtuar Kuvendit me disa vërejtje duke kërkuar sqarime plotësuese për disa dispozita të këtij ligji.

Shkresa u është shpërndarë të gjithë deputetëve si dhe Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport si Komision funksional dhe raportues.

Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, pas shqyrtimit radhazi në disa mbledhje vendosi që Kuvendit t'i paraqitet raporti i datës 22 maj 2006 me rekomandimet për të amendamentuar këtë ligj.

Arsyetimi për t'i mbështetur këto rekomandime mund t'i paraqet kryetarit të Komisionit z. Enver Hoxhaj, nëse natyrisht e sheh të arsyeshme.

Urdhëroni z. Hoxhaj.

DEPUTETI ENVER HOXHAI – I nderuari z. kryetar, i nderuari z. Ministër, të nderuar kolegë deputetë.

Komisioni ynë për arsim e mbështet plotësisht këtë raport, i cili ka ardhur nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut jemi marrë intenzivisht me të në disa mbledhje që kemi pasur. Kësaj radhe në këtë seancë kam vetëm një vërejtje dhe vërejtja është e natyrës teknike: teksti në gjuhën shqipe ka disa lëshime të natyrës teknike gjuhësore, nëse krahasohet me tekstin në gjuhën angleze e cila na ka ardhur nga Zyra e UNMIK-ut. Më lejoni në emër të Komisionit të sugjeroj që teksti në gjuhën shqipe do të duhej thjeshtë të harmonizohej me tekstin në gjuhën angleze. Ky sugjerim ka të bëjë më tepër me administratën e Kuvendit sesa me këtë seancë.

Dhe sugjerimi im i dytë është në emër të Komisionit për Arsim në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ky tekst, ky projektligj të votohet në tërësi meqë ne si Komision e kemi shqyrtuar dhe gjithë deputetët kanë pasur mundësi ta shqyrtojnë dhe besoj që edhe grupet e tjera parlamentare këtij Kuvendit, do ta mbështesin idenë që teksti si i tillë të votohet në tërësi. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Hydajet Hyseni e ka fjalën,

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar. Unë kam rezervë lidhur me propozimin që ne vetëm të themi të harmonizohet pa e parë se pastaj si do të duket teksti i harmonizuar, meqë edhe nuk e kemi tekstin anglisht, nuk jam krejt i sigurt, që pastaj kjo edhe po bëhet me saktësi, megjithatë mendoj që Kuvendi kur ta miratojë një ligj duhet ditur çka ka miratuar. Në fund të fundit ne mund ta bëjmë këtë dhe pastaj ta miratojmë në një seancë tjetër.

Unë e mbështes edhe vërejtjen që tha deputeti Hoxhaj, mirëpo dua të jem pak më konkret. Në nenin 30 paragrafi 3 formulime si, mirëpo mbrojtja janë shumë të pazakonshëm ,por mendoj që nuk duhet të figurojnë ose amendamenti i 5 që është propozuar, për mua është krejt i pakuptimtë, të keni vetëm pak durim ju lutem, nuk lejohet përdorimi i fjalimeve të tilla në formën e përmbledhjes që kryesisht përfshijnë fjalimet e autorit të njëjtë, asnjë kuptim nuk ka. Nuk e di si është në anglisht,por nuk bën të mbetet kështu, ose amendamenti 6 në gjithë tekstin kërkon që shprehja “agjenci” të zëvendësohet me asociacion kolektiv, pse ka asociacion individual është krejt i pakuptimtë, çdo të thotë asociacion kolektiv, kurse është në gjithë tekstin.

Unë sugjeroj që këto të harmonizohen paraprakisht dhe ne t'i votojmë një herë tjetër nëse natyrisht nuk ka ndonjë nevojë emergjente që ju mund ta dini më mirë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni profesor Hoxhaj,

DEPUTETI ENVER HOXHAI – I nderuari z. kryetar, ky ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm sa i përket plotësimit të standardeve në atë drejtim ne si komision e kemi dhënë maksimumin që vërtetë teksti si i tillë të harmonizohet. Pse kanë shpëtuar disa gabime të cilat për mendimin tim janë të natyrës teknike dhe ne nuk do të jemi në gjendje që tekstin anglisht në këtë seancë ta harmonizojmë hollësisht me tekstin shqip dhe për mendimin tim gjitha vërejtjet dhe sugjerimet konkrete janë të shumtën janë të natyrës teknike, prandaj kërkesa jonë ,si komision ishte që administrata e Kuvendit thjeshtë ta harmonizojë një tekst të tillë.

Ndryshime nuk do të jenë të natyrës thelbësore për shkak të urgjencës. Ne si komision kërkojmë vetëm një tekst i tillë të shkojë sa më shpejtë.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Unë do të shtoja edhe diçka, nën përkujdesjen e Komisionit, administrata e ka kryer këtë, por nën përkujdesjen e komisionit ftoj deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, për tekstin në tërësi natyrisht. Votojmë tash:

Konstatoj se Kuvendi i miratoi amendamentet dhe teksti në tërësi me 58 vota për, asnjë votë kundër. Kalojmë në pikën e radhës, pika e 8.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik për vitin 2005.

Raporti i punës i Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik të vitit 2005 i përgatitur nga Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik është shqyrtuar dhe analizuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, që ka bërë rekomandimet për Kuvend.

Materiali u është dorëzuar të gjithë deputetëve. Lus kryetarin e Komisionit për Buxhet, ta marrë fjalën.

DEPUTETI NASER OSMANI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik ka përmbushur obligimin ,sepse ia dërgoi raportin vjetor të punës Kuvendin e Kosovës, ashtu si e parasheh Ligjin për prokurimin publik nr. 2003/17 ,respektivisht neni 85 115, dhe 116 i këtij ligji.

Raporti në vete përmban aktivitete të Bordit të KRPP-së strukturën organizative të KRPP-së dhe aktivitete të departamenteve të KRPP-së. Kuvendi i Kosovës më 30 korrik 2004 ka emëruar anëtarët e Bordit dhe më 31 janar 2005 ka emëruar kryesuesin e KRPP-së, ndërsa në mars të vitit 2005 komisioni është kompletuar me personel ,që është bartur nga NEF-i në KRPP. Bordi i KRPP-së, krahas punëve në 48 takime formale dhe jo formale, ka aprovuar strukturën organizative të KRPP-së, Rregulloren e punës si dhe nxori kodin etik të prokurimit. Struktura e KRPP-së përbëhet prej 4 departamenteve,

1. Departamenti për Ankesa, në kuadër të cilët funksionon dhe paneli shqyrtues Ky departament në periudhën 11 shkurt deri në 28 dhjetor 2005 ka shqyrtuar 156 ankesa gjithsej 185 ankesa të parashtruara. Nga këto ka aprovuar 46 ankesa dhe ka marrë vendim për rivlerësim për 22 ankesa, ka anuluar 65 ankesa dhe 23 ankesa ka refuzuar sipas nenit të paraparë.
2. Departamenti për rregulla, i cili përveç tjerash ka kompletuar legjislacionin gjyqësor , si në përpilimin e dosjeve të tenderit dhe në hartimin e formularëve standardë, po ashtu ka bërë edhe udhëzimet administrative të nevojshme për plotësimin e legjislacionit në fjalë.
3. Departamenti i auditivit , ka vepruar sipas planit vjetor duke audituar(inspektuar) dhe vëzhguar dhe komentuar më se 160 dosje të aktiviteteve të prokurimit, si dhe departamenti për trajnime i cili ka vepruar me shumë vështirësi.

Në fund z. kryetar Komisioni për Buxhet dhe Financa ,gjatë shqyrtimit të këtij raporti ka shprehur shqetësimin e vet lidhur me rezultatet e auditimit. Komisioni ynë shpreh brengosje për numrin e vogël të auditorëve kundrejt 120 autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Komisioni është i pakënaqur me përgatitjen profesionale të zyrtarëve të prokurimit. Po ashtu Komisioni ka vërejtjen për planifikimin e dobët të procesit të prokurimit. Komisioni për Buxhet dhe Financa kërkon nga Kuvendi që menjëherë, pasi të aprovohet Ligji i përmirësuar për prokurimin publik të merren masa adekuate për ngritjen e efektivitetit më të madh të KRPP-së. Po ashtu organet kompetente të drejtësisë të jenë më efektive pas konstatimit të keqpërdorimeve eventuale nga auditorët.

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Osmani, fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KERMENDI – I nderuari kryetar, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë .

Vlerësoj se është detyrë dhe punë e mirë që ne sot ta shqyrtojmë raportin e Komisionit Rregullator për Prokurimin Publik të vitit 2005. Ky raport më tepër u dedikohet analizave dhe aktiviteteve të prokurimit publik dhe procedurave të shqyrtimit të ankesave, se sa të na sjellë një pasqyrë reale të gjendjes. Raportit i mungojnë shënimet dhe shkaqet që e kanë vështirësuar punën e këtij komisioni.

Sa është bërë koordinimi i punëve ndërmjet Komisionit qendror dhe atyre lokale të prokurimit, se sa është bërë aftësimi dhe certifikimi i personalitetit për prokurimPra, nuk kemi një pasqyrë të shkaqeve të mos zbatimit të Ligjit të Prokurimit Publik dhe një analizë se ku ato shkaqe gjegjësisht shkelje eventuale janë më të mëdha ose më të shprehura, sa është përcjellja e iniciativave të palëve të përfshira në procedurat e prokurimit. Nga raporti nuk kemi mundësi të kuptojmë se sa akte nënligjore apo urdhëresa administrative, janë realizuar në funksion të kësaj, mbi gjitha ajo që më së tepërmi më brengos në këtë raport është fakti se nga raporti nuk kemi mundësi të kuptojmë zbatimin e Ligjit për prokurimin publik dhe procedurat zbatuese dhe menaxhimi i fondeve publike në tërësi në pjesën veriore të komunave të Kosovës dhe kontët nëpër të cilat bëhet ky shfrytëzim.

Dhe në fund mendoj se raporti duhet të pasqyrojë udhëzimet për një efikasitet më të madh në prokurimin e mëtutjeshëm. Shpresoj se raportet e tjera do të jenë më të kompletuara. Megjithatë ndaj mendimin që ky raport si i tillë duhet të miea por në veçanti duhet të theksuar që duhet t'i përfshirë edhe pjesët e komunave veriore të cilat nuk përcillen në raport, dhe nuk përcjellën në shumë shënime të cilat i jep Qeveria e Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – I nderuari z. kryetar, të nderuar zotërinj deputetë. Nga raporti i Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik vërehet se është bërë shumë pak të respektohen procedurat e prokurimit, si dhe nuk ka qenë efektiv në shqiptimin e masave ndaj autoriteteve kontraktuese, menaxherëve, zyrtarëve të prokurimit për shkeljen e procedurave. Do të ishte mirë të kemi të dhëna të mjaftueshme se çfarë ka bërë Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik për zhvillimin e përgjithshëm të sistemit të prokurimit publik, çfarë ka bërë që sistemi i prokurimit të jetë në favor të shfrytëzimit racional dhe transparent të fondeve publike. Kjo bëri të inkurajohej konkurrenca dhe të respektohej barazia e pjesëmarrësve në procesin e prokurimit publik për të cilin është kompetent sipas Ligjit të prokurimit publik.

Nga raporti i Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik shihet se janë kryer 8 auditime, 24 inspektime 32 vëzhgime, është më shumë me interes që Kuvendi të ketë më shumë të dhëna në lidhje me inspektimet (monitorimet) dhe me auditivet e kryera.

Në raport thuhet, se një pjesë e aktiviteteve të prokurimit nuk kryhet në tërësi në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik. Janë shqetësues planifikimi i dobët dhe menaxhimi jodekuat i fondeve të alukuara nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, ku për pasojë ka pasur ngecje ndërmjet fillimit të procesit të prokurimit dhe procesit të sigurimit të fondeve.

Çështja e planifikimit jo të mirë është konstatuar jo vetëm nga Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik por edhe nga auditorët e brendshëm dhe nga auditimi i përgjithshëm, nuk jemi dhe ne nuk jemi në dijeni se cilat masa janë ndërmarrë që planifikimi të jetë në nivelin e duhur dhe në përputhje me Ligjin e prokurimit, çfarë masash janë marrë për respektimin e procedurave të tenderimit.

Në këtë raport është konstatuar se janë bërë shkelje të procedurave të prokurimit dhe janë keqmenaxhuar fondet publike, atëherë si mund të shpjegohet çështja që vetëm një lëndë i është drejtuar prokurorisë publike dhe vetëm ndaj 9 menaxherëve të prokurimit janë shqiptuar masa.

Mënyra si u morën vendimi dhe veprimet, sipas Rregullores së Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik duhet të jetë efektive, transparente dhe përgjegjëse ndaj Qeverisë, Kuvendit dhe qytetarëve të Kosovës.

Por, shtrohet pyetja, sa ka qenë transparent dhe i përgjegjshëm Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik dhe nëpërmjet cilëve mekanizma ky komision do të ishte transparent ndaj qytetarëve. Si mund të njoftohen palët e interesuar p.sh. për vendimet e panelit shqyrtues dhe si mund të shihet raporti i ekspertizës?

Në raport si shqetësim kryesor janë theksuar disa herë: numri i vogël i anëtarëve të stafit dhe mungesa e automjeteve për punë në terren. Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik në fillim të vitit 2005 i është ndarë buxheti prej 346.000 euro që me vlerësim janë shtuar mjetet me vlerë prej 110 mijë euro, pra Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik, buxhetin e tërësishtëm e ka pasur 456.000 euro.

Ky shtim i buxhetit pikërisht është në pozicionin :paga dhe mëditje dhe shpenzime kapitale. Nga raporti shihet se kanë mbetur pa shpenzuar 18.577 euro, vetëm në kategorinë: paga mëditje kanë mbetur pa shpenzuar 16.000 euro, atëherë, pse nuk është kompletuar stafi, sepse për pasojë pati vështirësi në kryerjen e auditimeve apo në shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë.

Me rivlerësim janë ndarë 55.000 euro për blerjen e automjeteve, si mund të arsyetohet se me këto mjete është blerë vetëm një veturë për drejtorin e Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik apo për kryetarin e Komisionit, kur ka mungesë të theksuar të automjeteve për punë në terren, sepse me këto mjete ka pasur mundësi të zgjidhej ky problem.

Sa mund të kontribuojë në shfrytëzimin racional efektiv të fondeve publike Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik, ku komisioni vetë i keq menaxhon mjetet dhe i

keqpërdor fondet publike. Në raport nuk thuhet asgjë si është marrë vendimi për pagesën e anëtarëve të bordit, sipas cilit koeficient paguhen anëtarët e bordit, por bordi pa kurrfarë baze ligjore më d 15. 4.2005 merr vendimin që e miratoi edhe Ministria e Shërbimeve Publike dhe nuk është e vërtetë, si tha z. kryeministri se vendimi u miratua nga Qeveria, sepse në bazë të këtij vendimi paguhej Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik. Shihet se këtë vendim e mori Komisioni- bordi i Komisionit Rregullator të Prokurimit, por e nënshkroi Ministria e Shërbimeve Publike dhe sipas kësaj baze paguhej bordi dhe dr nuk ka pasur kurrfarë vendimi tjetër të Qeverisë në bazë të së cilës është bërë pagesa.

Sipas nenit 86.2 secili anëtar i Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik ka statusin e nëpunësit civil. Në asnjë ligj , me të cilën rregullohet procedura e pagesës së stafit civil, nuk ka ndonjë koeficient, me të cilën ndonjë anëtar i stafit civil do ti mundësonte pagë me vlerë 1005 euro.

Por,si mund të arsyetohet se anëtarët e bordit pa kurrfarë baze ligjore t'ia caktojnë pagën vetvetes?. Zëvendëskryeministri për pyetjen që e bëra pak më parë tha se këta anëtarë të bordeve e kanë një trajtim të veçantë, sa i përket pagesës. Nëse këta paskan trajtim të veçantë ,atëherë duhet të nxirret një rregullore apo një udhëzim në bazë të së cilës do të bëhet pagesa e tyre, përndryshe ne nuk jemi në dijeni që Qeveria e ka ndonjë rregullore me të cilën rregullohet kjo çështje dhe është shumë diskutabile pagesa e gjitha bordeve që bëhet për shkak një çështjeje të tillë. Ne edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa e kemi shqyrtuar dhe kemi dhënë rekomandim për Kryesinë që të merret një vendim në lidhje me caktimin e pagave të këtyre bordeve ,se çka është bërë më tutje në rekomandimin tonë nuk kam dijeni.

Komisioni Rregullator ka caktuar kodin etik të prokurimit, mirëpo Komisioni Rregullator i Prokurimit Publik shkel ligjin, nuk respekton as kodin etik që vetë e ka nxjerr. Bordi i Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik ,si dhe kryetari i këtij bordi, emërohen nga Kuvendi, prandaj Kuvendi duhet të angazhohet seriozisht për kontrollimin e mirëfilltë të punës së këtij komisioni dhe për kontrollimin e buxhetit në tërësi që të mos tolerohet edhe më tutje keqpërdorimi i buxhetit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka Gjylnaze Syla

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit i nderuari z. kryetar, deputetë, ministra.

Grupi Parlamentar i Aleancës konsideron se është me rëndësi të madhe që v procedurat dhe aktivitetet e prokurimit publik, sidomos për shkak nga kjo varet edhe shfrytëzimi i drejtë i fondeve dhe i burimeve publike. Prandaj duhet të jetë menaxhimi i mirë dhe transparent i fondeve publike. Në raportin e dërguar nga Komisioni Rregullator për Prokurim Publik është e qartë se duhet të përmirësohen praktikat e aktiviteteve të prokurimit, sidomos të atyre aktiviteteve që kanë të bëjnë me proceset e prokurimit që janë rezultat i planifikimit të dobët dhe i menaxhimit jo adekuat të alokimit të mjeteve të

publikimit të kontratës, të njoftimit për kriteret e dhënies së kontratës dhe sigurimin e tenderëve.

Prandaj, konsiderojmë se raporti i komisionit për vitin 2005, duhet të ishte edhe më i plotë me më shumë të dhëna më shumë hollësi që përmbajnë analiza të hollësishme të aktiviteteve të prokurimit publik, dhe të procedurave të shqyrtimit të ankesave ,duke përfshirë edhe punën e katër departamenteve që përbëjnë Komisionin dhe në fund vetë raportin financiar të detajuar. Mendoj se ,gjithashtu, raporti duhet të përmbajë rekomandimet adekuate dhe masat përkatëse për avancimin e sistemit të prokurimit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Meqenëse nuk ka diskutues të tjerë, lus deputetët dhe regjinë të përgatitet për votim me vërejtjet që iu dhanë. Votojmë tash.

Nuk kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve për votim. Ftoj deputetët që nuk gjenden në sallë, le të kthehen sa më parë në sallë të votojmë.

Kam konfirmimin që në sallë momentalisht gjenden 64 deputetë, mund të vazhdojmë me votim. Lus regjinë të përgatitet për: votojmë tash:

Për 45,
Kundër.....16.

Miratohet raporti me këto vërejtje.

Pika 9 e rendit të ditës.

9. Interpelanca e ministrit Ardian Gjini me kërkesë të deputetit Naser Osmani dhe të dhjetë deputetëve të tjerë nga radhët e Grupit Parlamentar të LDK-së

Urdhëroni z. Gjini, vetëm një moment, në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Naser Osmani dhe 10 deputetë të tjerë nga radhët e Grupit Parlamentar të LDK-së i janë drejtuar Kryesisë së Kuvendit të Kosovës me kërkesë për ta ftuar në interpelancë ministrin e Qeverisë së Kosovës z. Ardian Gjini. Interpelancën e parashtruar Kryesia ia ka dërguar ministrit Gjini për shqyrtim dhe përgjigje, në afatin e paraparë me Rregulloren e punës ministri ka konfirmuar në seancën plenare,në të cilën do të shqyrtohet interpelanca.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 25 pika 7 të Rregullores së punës së Kuvendit ,përfaqësuesi i interpelancës, z. Naser Osmani mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje prej 10 minutash dhe në përmbyllje të debatit deri në 5 minuta, ndërsa koha e ndarë për grupet parlamentare e reflekton përfaqësimin e tyre në Kuvend si vijon. Së pari ftoj përfaqësuesin e Komisionit, kryetarin z. Naser Osmani ta marrë fjalën.

DEPUTETI NASER OSMANI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar ministër Gjini edhe i nderuari zëvendëskryeministër Haziri. Inkurajohem për durimin që e patet të rri deri në fund të seancës. Pajtohem me ju të mos e humb një ditë të vlefshme që radhitet gjithmonë në pikën e parë të rendit të ditës.

Z. kryetar, Kosova ka një vegjetacion të bujshëm, ka një natyrë të bujshme, të mirë të bukur dhe qytetarë e Kosovës gjithmonë kanë jetuar në harmoni me natyrën. Mirëpo, kohët e fundit vërehet një shkatërrim i natyrës në një mënyrë të planifikuar. Kjo ka ngjallur shqetësim te qytetarët veçanërisht tek unë, kam kërkuar nga ju z. ministër, të jeni sot në interpelancë për të dhënë disa sqarime që kanë të bëjnë me këtë dukuri të shëmtuar. Kam bërë incizimin në terren të kësaj dukurie që e kam paraqitur edhe në Kryesi edhe të ju. Dua të përmend këtë dukuri vetëm në dy relacione, prej Shtimes deri në Caralevë që s'i ka më së 5 km. në 24 vende bëhet mihja e pa planifikuar e tokës duke shfrytëzuar gurët.

Në rrugën Kaçanik Hani i Elezit janë diku rreth 7 vende ku është rrëmihur toka dhe pasojat janë të pasanushme. Në Gadime, që ne konsiderojmë si vend turistik, në 7 vende është mihur toka dhe shkatërrohet natyra. Kjo ndodh edhe në kodrën e Goleshit edhe në shumë pjesë të Kosovës. Për shkak të gabimeve në procedurë gjatë parashtrimit të pyetjeve për interpelancë, unë do të lexoja një rekomandim që ju z. ministër të angazhoheni që urgjentisht Qeveria t'i regjistrojë të gjitha rastet e shfrytëzimit të pa ligjshëm të tokës. T'i merrni të gjitha masat e nevojshme për ndalimin e menjëhershme të shfrytëzimit të paligjshëm të tokës, t'i sanksiononi këto veprimtari dhe brenda një afati të caktuar mundësisht të mos na raportoni për rezultatet e arritura nga ju.

Pyetja e parashtruar z. ministër do ta lexoja edhe një herë meqenëse e kanë të gjithë deputetët. Pyetja është kjo:

1. Pse u lejuan shfrytëzimi dhe grryerja e tokës nga kompani të ndryshme për nxjerrje të zhavorrit dhe të mineraleve tjera, pa planifikim dhe duke u shkaktuar dëmtimi të madh tokës dhe mjedisit. të cilat sipas ligjit janë në kompetencë të ministrisë tuaj për mirëmbajtje dhe mbikëqyrje?
2. Çfarë do të ndërmerri për ta ndërprerë këtë veprimtari të paligjshme dhe si do t'i sanoni pasojat e kësaj katastrofe që njeriu ia bëri natyrës Ju faleminderit

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ftoj ministrin Ardian Gjini ta paraqes qëndrimin e Qeverisë lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryesues, zëvendës kryeministër, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, fillimisht do të doja ta falënderojë z. Osmani dhe dhjetë deputetë e LDK-së dhe Grupit Parlamentar të LDK-së që e kanë ngritur këtë çështje në Kuvendin e Kosovës.

Ky falënderim vjen me sinqeritetin më të madh për shkak se ka qenë një angazhim tejet i madh në Ministrinë e Mjedisit dhe çështje që unë e kam marrë shumë afër gjatë një viti e gjysmë sa e drejtoj këtë ministri, se është ekzakt i ,.....

Çështja e mbrojtjes së ujërave dhe çështja e mbrojtjes të kësaj pasurie të Kosovës, deri më tani nuk janë shtruar në këtë mënyrë dhe ju falënderoj edhe një herë që ma keni dhënë rastin t'ju tregojë çka kemi punuar deri më tash dhe ku janë problemet. Kjo ku qëndrojnë problemet ka të bëjë me faktin se, më duhet të pajtohem me deputetin Osmani ,se nuk e kemi situatën ashtu siç dëshirojmë ne ta kemi.

Para se të filloj të përgjigjem pyetjes do t'ju jap një pjesë të kontekstit të gjithë asaj që e kemi këtu. Ky Kuvend mua më ka votuar për herë të parë për ministër në mars të vitit të kaluar. Vetëm një muaj pas emërimit kam kërkuar që të nxirret Rregullorja për ndalimin e plotë të shfrytëzimit të gurëve, të zhavorrit dhe të inerteve të tjera prej shtretërve dhe brigjeve të lumenjve. Është hartuar një vendim i tillë dhe është nënshkruar më 5 qershor të vitit të kaluar. Me 5 qershor për shkak se ka qenë dita e mjedisit dhe kemi dashur ta kemi një element simbolik të bashkangjitur me nënshkrimin e asaj rregulloreje.

Deri atëherë ka qenë një rregullore e hartuar në Ministrinë e Mjedisit nga kolegët e mi ministra paraprakë, por ka qenë vetëm për pjesën e Dukagjinit, ku edhe dëmet janë më të mëdha në brigjet dhe shtretërit e lumenjve. Unë kam kërkuar që ajo të vlejë për gjithë Kosovën. Ajo ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit. Një pjesë tjetër që duhet të shtohet si pjesë e kontekstit për shpjegim të gjithë kësaj çështjeje , është se pak njerëz në Kosovë e dinë, pra pak qytetarë të Kosovës e dinë se ajo , është vendi më i varfër me ujëra në tërë rajonin mos të them tërë Evropën se me siguri është edhe në tërë Evropën.

Kjo mbron ujin si pasuri natyrore prioritare .por edhe mbrojtja e gurëve, e zhavorrit dhe e shtretërve i shërben paraprakisht mbrojtjes së pasurisë ujore e jo vetëm të inerteve për.....

Duke shfrytëzuar këtë rast bëj apel, unë do të them se çështja që po ngremë sot duhet të jetë diçka që i shërben secilit prej jush që ta shtrijmë ndikimin e madh që e keni nëpër komunitete për shkak se mbrojtja e lumenjve dhe mbrojtja e natyrës nuk mund të bëhet vetëm prej institucioneve. Pyetja që shtrohet- pse është lejuar degradimi .mund të shtrohet në cilëndo fushë të jetës, pyetja mund të shtrohet- pse ka pasur kaq shumë ndërtime pa leje pas luftës edhe shumë pyetje të tjera pse. Kjo shkon në kontekst të situatës të cilën jemi gjendur, menjëherë pas luftës dhe do të kisha thënë se duhet të konstatohet këtu me ato që do t'i them tash e tutje, përmirësim i gjendjes në dy vjetët e fundit. Këtë do ta dëshmoj. Ekziston gjendje që duhet të sanohet shumë shpejt, mirëpo gjendja nuk ka shkuar duke u keqësuar por ka shkuar duke u përmirësuar.

Pas vendimit për ndalimin e shfrytëzimit të gurëve dhe të zhavorrit ka qenë i bazuar në Ligjin për mbrojtjen e natyrës të vitit 2005/2 dhe në Ligjin për mbrojtjen e mjedisit 2003/1, kemi pas një zhvendosje të operatorëve nga brigjet e lumenjve dhe bregu i lumit është prej cepit të lumit 50 metra, në tokën bujqësore. Pjesa e kontekstit është se toka bujqësore nuk menaxhohet nga Ministria e Mjedisit ,por nga ajo e Bujqësisë.

Ajo që bën Ministria është vetëm dhënia e pëlqimit mjedisor për operator, ndërsa pëlqimi mjedisor është vetëm një prej dokumenteve që i shërben Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale që të licencojë, do të thotë Ministria nuk licencon, por jep vetëm pëlqim mjedisor.

Do t'jua jap vetëm disa informacione lidhur me pëlqimet mjedisore që i ka dhënë Ministria.

Në vitin 2003 janë miratuar 9 pëlqime mjedisore, nuk është refuzuar asnjë. Në vitin 2004, 54 pëlqime mjedisore, nuk është refuzuar asnjë, në vitin 2005, 75 pëlqime mjedisore, 4 janë refuzuar, kurse në vitin 2006 e deri më tani 81 pëlqime mjedisore, 15 janë refuzuar. Gjithsej janë 219 pëlqime mjedisore, 19 janë refuzuar

Do t'ju them shumë shkurtë çka nënkuptohet me këto shifra Deri në vitin 2005 nuk kemi raste të refuzuara për shkak se nuk ka pasur rregullore që do ta ndalonte dhënien e pëlqimit mjedisor për një shfrytëzim të tillë. Pas vitit 2005 me hartimin e Rregullores kemi rastet të cilat janë refuzuar.

Do të kalojë më tutje në punën tonë të deritashme Krahas ligjeve që janë hartuar dhe përpos Rregullores që është nxjerrë dhe e cila ka të bëjë direkt me këtë çështje, kemi pasur edhe intervenime me rastin e mbrojtjes të monumenteve të natyrës si i quajmë p.sh. për Shpellën e Gadimes është nxjerrë një rregullore që ndalon çfarëdo veprimtarie të eksploatimit të inerteve në tri kilometra vijë ajror rreth shpellës së Gadimes. Kjo ka ndodhur në vitin e kaluar, pas ankesave që i kemi marrë prej banorëve të asaj ane, që e kanë pasur një kujdes të shtuar për atë pasuri që e konsiderojnë të veten.

Deri më tani (deri në dhjetor të vitit të kaluar) kemi pas 20 urdhëresa për ndalimin e eksploatimit, kanë kaluar shumë lëndë në gjykatë e kam konfirmuar pas pyetjes që e kam marrë kanë kaluar nëpër gjykata, kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë sidomos me komunën e Pejës, me komunën e Klinës dhe të Prizrenit, posaçërisht lidhur me gurëthyesit. Do të kthehem shkurtimisht te gurëthyesit. Ata janë të licencuar, si thashë nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe në momentin kur është ndaluar eksploatimi i inerteve nga shtretërit e lumenjve, është dashur të orientoheshim nga gurëthyesit, mirëpo çështja e tyre ka të bëjë me ndikimet mjedis ashtu si tha deputeti Osmani. Deri më tani operatorët që nxjerrin gurët nuk i kanë gjitha dokumentet e plotësuar, përveç një numri shumë të vogël të tyre. Orientimi nga gurëthyesit ka ardhur për shkak se i kam shtruar pyetjet fillimisht para se të nxjerrim rregulloren, a ka Kosova gurë të kualitetit të caktuar që do t'i plotësonin nevojat dhe do ta zëvendësonin zhavorrin nga lumenjtë? Përgjigjja ka qenë po, a ka të mjaftueshëm pa e cenua mjedisin, përgjigjja ka qenë po. Ajo çka duhet të ndodhë është se gurëthyesit duhet të punojnë, ata duhet të aktivizohen, duhet të ndalohet shfrytëzimi i inerteve natyrore, do të thotë të lumenjve, mirëpo duhet të kemi pëlqim mjedisor të saktë, duhet të jenë zonat në të cilat nuk ka rrezik për shembje dhe e të cilat do të mund të vijnë si pasojë e kësaj.

Ne kemi kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve që licencimi i prodhuesve të betonit, të kushtëzohet me shfrytëzim të inerteve të cilat kanë pëlqim mjedisor, do të thotë prej gurëthyesve, fillimisht e kemi marrë një pëlqim, mirëpo kur nuk u realizua kjo kërkesë jona. Duhet të ndërliidhen tash para se të përfundojë kjo pjesë e parë me pyetjen e cila u shtrua paraprakisht nga deputeti i nderuar që ka të bëjë me këtë çështje. Unë e kam udhëhequr i emëruar nga kryeministri i Kosovës në atë kohë e kam udhëhequr Komisionin për evidentimin dhe sanimin e pasojave të vërshimeve të vjeshtës të kaluar. Ne kemi përfunduar një raport të punës e cila e kemi dorëzuar në Qeveri edhe te Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ai ka qenë obligimi i ynë ligjor, në atë dokument final unë kam kërkuar eksplicit rekomandimet të jenë të sakta se çfarë duhet bëhet, ajo çka mund t'ju them juve sot është kështu, kthehem te buxheti, e kam përmendur një herë në këtë Kuvend të respektuar se trajtimi ujërave të zeza dhe sanimi i gjendjeve nëpër lumenjtë do t'i kërkojë diku 500 deri 600 milion euro, nuk e kam dyshimin as ma të vogël se ju deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës e kuptoni se çfarë shume të mjeteve është kjo për Kosovën dhe sa kohë do të na merr.

Të njëjtën kohë ne kemi mundësi të fillojmë të sanojmë aty ku duhet, mirëpo ajo çka na nevojitet urgjentisht është që të punojmë për çdo ditë në terren, jo vetëm Ministria, jo vetëm pesë inspektorë të Ministrisë, jo vetëm inspektorët komunalë, por secili prej nesh që të mos e degradojmë më tutje për shkak se sanimi do të na kushtojë. Në fund të fundit do të them se ne e kemi përgatitur edhe një projektmemorandumit të mirëkuptimit me komunat, sidomos me komunat të cilat janë shumë më tepër të atakuara me këtë dukuri si me me komunën e Rahovecit, të Prizrenit, të Gjakovës, Klinës, Pejës dhe të Burimit. Në memorandum ne do t'i ndajmë punët me komunat, me inspektoratet komunale, në mënyrë që të arrijmë dhe të kemi efektivitet sa më të madh të parandalimit të kësaj dukurie. Mirëpo kjo kursesi nuk bënë të kuptohet secilido institucion që duhet të presë autorizim prej dikujt që ta zbatojë ligjin, do të thotë diçka një dokument një ligj i cili është valid e asnjë qytetar asnjë institucion nuk duhet të kërkojë autorizim ose leje që ta zbatojë.

Gryerja e lumenjve, shkatërrimi i brigjeve të tyre sot janë të jashtëligjshme në Kosovë, dhe cilido inspektor i komunës cilido polic, cilido qytetar i Kosovës me vetë faktin se është e jashtëligjshme e ka të drejtën të donencojë edhe këtë do ta kem si apel sot nuk duhet pritët si autorizim për të donencuar ata që e thyejnë ligjin. Ju faleminderit!

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – ju faleminderit z. ministër, fjalën e ka deputeti Fadil Gashi le të përgatitet deputeti Ali Sadriu.

DEPUTETI FADIL GASHI – Ju faleminderit z. kryesues, z. ministër. Zonat mbrojtëse dhe përmendet edhe Klinën nga vi unë, unë kujtoj që Ministria dhe pushteti lokal në këtë rast, komunat duhet të bashkëpunojnë më shumë në mes veti. Unë po jua jap një shembull, që në Klinë Ujëvara e Mirushës është zonë e mbrojtur, unë këtu kam një shkresë të Ministrisë të datës 11.05.2004, që obligon komunën dhe thuhet, pasi ngritja e pompës për karburante është brenda zonës së mbrojtur të parkut të Mirushës dhe është në kundërshtim me qëllimin e mbrojtjes MMPH kërkon që autoritetet komunale të Klinës

menjëherë ta ndalin këtë aktivitet dhe t'i obligojnë investitorin dhe kryesin e punimeve ta sanojë sipërfaqen e degraduar dhe atë ta kthejë në gjendjen e mëparshme.

Kjo shkresë është e nënshkruar prej sekretarit, ushtrues i detyrës në atë kohë, Muhamet Aliut. Komuna i ka filluar të gjitha procedurat deri në konkluzën e fundit për rrënim të atij objekti dhe si rrjedhojë kompania më 29.12.2005 e solli tjetrën shkresë prej Ministrisë, të nënshkruar nga sekretari Muhamet Aliu, që ia ka dhënë pëlqimin për ndërtim dhe komuna nuk di cilin ta zbatojë tash në këtë rast.

Ceket se edhe inspektorët komunalë duhet ta kenë të drejtë vetëm të presin procesin në ato vende ku shfrytëzohet zhavorri në mënyrë të egër, por nuk kanë kompetencë për masa ndëshkuese. Këtë të drejtë e ka vetëm inspektori rajonal, ata duhet ta bëjnë procesin, inspektori komunal dhe t'ia dërgojë inspektorit rajonal, pastaj duhet të merren 5 komunat në nivel rajoni, por dihet sa efikasiteti mund të jetë i shpejtë. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – E ka fjalën deputeti Ali Sadriu, le të përgatitet deputeti Xhevat Bislimi.

DEPUTETI ALI SADRIU – Ju faleminderit z. kryesues, ju përsërites juve, ministrin, kolegë të nderuar.

Falënderoj ministrin për këtë prezantim të një teme shumë aktuale dhe pata kënaqësinë të dëgjoja të dëgjoja për disa masa që merren ndaj asaj si të mbrohet ambienti, por në dy pika nuk pata rast të dëgjoja, është fjala për ujërat e zeza dhe trajtimin e tyre, që jemi të gjithë të vetëdijshëm sa dhe si a trajtohen ato në mënyrë adekuate dhe si vendoset për pikat e karburantit në afërsi të lumenjve apo të ujërave nëntokësore. U cek më parë rajoni i Shtimjes nga një formë tjetër e gjurmimit apo nga forma të tjera të prishjes së ambientit, unë po e cek vetëm rastin e pikave të karburantit.

Para luftës ishte një pikë karburanti, kurse pas luftës janë 8 ose 9, në një distancë 8 km. Të gjitha thuaja se janë afër bregut të lumit ose në sipërfaqe, ku ka ujëra nëntokësore të rezervave të mëdha prej nga furnizohet Shtimja me fshatra, pastaj Lipjani. Fushë Kosova e ka të njëjtin problem, Vuçitërna e kështu me radhë. Mbrojtja e lumenjve mendoj që është një prej detyrave më prioritare kur kemi parasysh se edhe ju e thatë që Kosova është e varfër, e në veçanti nga lumenjtë që janë më të gjatë në Kosovë, se Kosova ka pasur një fat jo të mirë- lumenj të mëdhenj burojnë në Kosovë, por rrjedhin shpejtë dhe kalojnë jashtë Kosovës. Vetëm Drini i Bardhë dhe Sitnica janë dy lumenj që më gjatë shkojnë nëpër Kosovën. Ta marrim Sitnicën dhe ruajtjen e saj.

Unë mendoj se është koha e fundit që në këtë drejtim ekspertë tuaj të hartojnë një platformë për mbrojtjen dhe trajtimin e ujërave të zeza, në radhë të parë të Sitnicës që më parë ishte ndotur me fenol, por tash trajtimi i ujërave të zeza është shumë aktual për shkak të pikave të furnizimit me karburantit që dihet se ato janë ndotësit më të mëdhenj të ambientit, në veçanti aty ku ka resurse të mëdha të ujërave nëntokësore.

Do të kisha pasur dëshirë që në këtë drejtim ,në një të ardhme z. ministër të na raportoni se çka keni ndërmarrë dhe cilat janë planet tuaja. Ju faleminderit

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. deputetë. E ka fjalën z. Xhevat Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit z. kryesues. Pajtohem me atë që tha ministri se Kosova vërtet është e varfër me ujëra dhe se secili prej nesh duhet të jetë i ndërgjegjshëm për këtë pasuri jetike që i duhet Kosovës ta ruajë, por secili prej nesh e shikon dhe e përjeton, dikush më rëndë e dikush ma lehtë, ndotjen e madhe të këtyre ujërave me hedhjen e mbeturinave e të ndotësve kudo nëpër lumenj, në prraska dhe me një farë mënyre këta lumenj dhe përroskat tona janë shndërruar në deponi mbeturinash. Kur t’i shtohet kësaj edhe derdhja e ujërave të zeza në këta lumenj e në përroska, atëherë mund të konstatojmë se jemi para një katastrofe të mirëfilltë ekologjike. Degradimi i këtyre lumenjve dhe stërmbushja, ose mosmirëmbajtja e brigjeve të këtyre lumenjve e prraskave shpeshherë ka shkaktuar edhe vërshime të mëdha, që u kanë bërë dëme të mëdha ekonomive bujqësore familjare, por ndonjëherë edhe biznesit nëpër komunat të ndryshme në tërë Kosovën.

Në Viti, në maj të vitit të kaluar ,p.sh., janë vërshuar, sipas vlerësimit të Komisionit komunal - më se rreth 900 hektarë tokë bujqësore, rreth 13 fshatra kanë pësuar dëme më të mëdha ose të vogla dhe po ky komision komunal llogariti se dëmi i përgjithshëm në komunën e Vitisë ka qenë 1.243.555 euro. Kjo ndoshta i takon edhe Ministrisë së Bujqësisë. Do të kisha dashur të dëgjoja nga ministri i Bujqësisë a është ndërmarrë diçka në lidhje me këtë dhe a llogaritet t’u ndihmohet këtyre ekonomive familjare bujqësore të komunës së Vitisë, po edhe të viseve të tjera të Kosovës?

Kurse nga ministri i Mbrojtjes së Ambientit kërkoi të shtohen kontrolli e inspektimi, të shtohet bashkëpunimi me komunat, sepse në fund të fundit ndoshta trajtimi i ujërave të zeza kërkon shuma të mëdha parash dhe e dimë mungesën e tyre, por ndalimi i hedhjes së mbeturinave nëpër lumenj ,nëpër lëndina e kudo në natyrë, pa asnjë kontroll ,besoj që nuk kërkon shuma të mëdha parash ,por inspektim dhe kontrollim më të rreptë nga ana e inspektorëve komunalë dhe e inspektorëve të Qeverisë dhe një bashkëpunim midis Qeverisë dhe komunave, që të parandalohet kjo katastrofë ekologjike. Ju faleminderit.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. deputet. E ka fjalën ministri Gjini.

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryesues. Unë tentova që t’i mbledhja disa nga pyetjet, komentet dhe sugjerimet që i mora nga ju të gjithë, me shumicën prej tyre nuk kam si të mos pajtohem - është e saktë se duhet të rritet inspektimi dhe është e saktë se duhet të rritet bashkëpunimi me komunat. Thash se disa elemente të fillimit janë hartuar – memorandumet e mirëkuptimit ,që ta ngritnim në një nivel tjetër këtë bashkëpunim,por edhe tjetër- prapë -si pjesë e apelit që dua të them- është kjo, është e vërtetë se ka procedurë, si e përmendi deputeti i nderuar prej Klinës, ka procedurë prej

inspektorëve komunalë, në mënyrë që të arrijnë lëndët deri te ne. Mirëpo, do t'ju shpjegoj se çfarë është procedura. Inspektorët komunalë hartojnë një proces, ai proces shkon te inspektori rajonal, inspektori rajonal nëse nuk mund ta zgjidhë vetë e dërgon në Ministrinë e Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor dhe ne në bazë të Ligjit e të rregulloreve, nëse mund të shqiptojmë gjoba, i shqiptojmë ose i dërgojmë në gjykatë. Kjo është e tërë procedura.

Nëpër komuna duhet të bëhet një pyetje sa procese i kanë bërë në vitet e fundit. Vetëm një pyetje shumë e thjeshtë dhe do të shohim a është problemi te procedura apo është problemi diku tjetër.

Një pyetje e thjeshtë, ju lutem, sa procese i kanë hartuar deri më tani.? Te zonat mbrojtëse te Klina është e vërtetë unë kaloj asaj rrugë çdo ditë, e shoh dhe më besoni se e ndjej, ka shkuar një rregullore- pëlqime mjedisore për pika karburanti nuk japin, nuk japin për shkak se është stërngarkuar.

Një pjesë tjetër e legjislacionit që mund të ndihmojë shumë në rregullimin e kësaj çështjeje është Ligji për trajtimin e ndërtimeve ilegale që do të jetë se shpejtë para jush, ai ligj do të ndihmojë, do të thotë do ta komplementojë këtë punë sa i përket mbrojtjes së mjedisit në zonat e mbrojtjes, posaçërisht, fjalën e kishit te zona e mbrojtur e ujëvarave të Mirushës. E njëjta gjë do të thotë në pjesën e pyetjes së deputetit Sadriu për pikat të karburantit, prapë do të kalojmë në çështjen e trajtimit të ndërtimeve ilegale për shkak se shumica dërrmuese nuk kanë pëlqim mjedisor edhe numri i madh nuk kanë as leje ndërtimi. Kjo e nxjerr atë pjesë të kompleksitetit të qeverisjes.

Në Kosovë nuk ka qeverisje piramidë që shkon prej ministrit ose prej kryeministrit, mirëpo ka pjesë serioze të qeverisjes nëpër komuna të cilat po ashtu janë zgjedhur në mënyrë shumë demokratike edhe e kanë pjesën e vetë të përgjegjësive në të cilat ne nuk mund të involvohemi, te pastrimi i ujërave të zeza dhe të mbrojtja e Sitnicës- të pastrimi i saj që u përmend disa herë, është pjesë specifike e raportit pas vërshimeve të vitit të kaluar. është hartuar plani i Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor. Ekzistojnë plani dhe strategjia e sanimit të gjendjes së Sitnicës. Arsyeja e vetme pse nuk është zbatuar deri më tani janë mjetet financiare. Ky është harmonizuar edhe me komunat, sidomos me komunën e Fushë Kosovës dhe të Kastriotit.

Unë prapë do të jem në gjendje të vazhdojë me përgjigje, nëse diçka kam harruar prej atyre që më pyetën deputetët e nderuar. Ju faleminderit

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. ministër, kalojmë në pikën e 10 të rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i propozimeve për emërtimin e anëtarëve të 8 komisioneve funksionale.

Në pajtim me ndryshimet e bëra për rritjen e numrit të anëtarëve të komisioneve funksionale nga 12 në 14, janë bërë propozime nga grupet parlamentare.

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që t'i paraqesin propozimet. E ka fjalën z. Alush Gashi.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryesues, Grupi Parlamentar i LDK në shkresën 02-2341, të 29 qershorit 2006 i është përgjigjur kërkesës suaj për plotësim të komisioneve. Në shkresën tonë prej numrit 1 deri 8 i japim propozimet për 8 komisione nga 1 anëtar, sot në fillim të seancës u konstatua që z. ministër nuk mund të jetë në Komision dhe eventualisht mund të shikohet si konflikt interesash , andaj në shkresën tonë zyrtare lusim që në pikën 5 në vend të propozimit të z. deputetë Behxhet Brajshori të jetë deputeti Ilmi Ahmeti dhe pas pikës 8, në pikën 9 që shtohet kërkojmë që në Komisionin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euro Atlantike në vend të deputetit Ilmi Ahmeti të jetë deputetja Brikenda Kryeziu, me shpresë që i merrni në konsiderim propozimet tona i falënderojmë.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit. E ka fjalën z. Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI - Ju faleminderit z. kryesues. Siç e dini Grupi Parlamentar për Integritet i ka parashtruar kërkesat e tij në mënyrë të përsëritur për emërimin e deputetëve-anëtarë të këtij grupi parlamentar në komisionet e Kuvendit të Kosovës. Me të vërtetë marrin një kohë të gjatë, por megjithëkëtë çdo gjë që përfundon mirë në fund ,duhet të pajtohemi me të. Ju e keni përpara shkresën e fundit, e kjo ka qenë kërkesa e tretë për Kryesinë e Kuvendit të Kosovës, në të cilën janë të paraqitur deputetët e Grupit Parlamentar për Integritet sipas komisioneve funksionale, kështu që presim që Kuvendi i Kosovës ta miratojë.

KRYESUESI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. deputet. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së janë propozuar 2 deputetë: Ramë Buja- anëtar i Komisionit për Arsim, Shkencë, dhe Teknologji dhe Selvije Halimi .anëtare e Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Planifikim Hapësinor.

Ftoj që regjia të bëhet gati për votim dhe të votojmë.

Në sallë janë 68 deputetë.

Votojmë tash:

Për55

Kundër 5

Miratohet propozimi.

Këtu merr fund kjo seancë dhe mirë u pafshim në seancat e ardhshme.